



aktivitete 2019



KOMUNITETI MYSLIMAN I SHQIPËRISË

aktivitete

Komuniteti Mysliman i Shqipërisë
Aktivitetet 2019

Editor

Agron Hoxha
Erzen Carja

Dizajn

Hysen Vogli

ISBN 978-9928-194-83-1

Tiranë 2020

Adresa:

Rr. George W. Bush, nr. 50, Tiranë

Tel: (+355) 42 230 492

info@kmsh.al

www.kmsh.al

Komuniteti Mysliman i Shqipërisë është një institucion me traditë në Shqipëri, themelimi zyrtar i të cilit daton më 1923 dhe për t'u rihapur më 1990.

Në ushtrimin e veprimtarisë së tij, si një institucion fetar e bamirës, ka si qëllim të përhapë, zgjojë dhe forcojë tek të gjithë, besimin islam, të ruajë traditën e trashëguar nga të parët tanë, të mbrojë dinjitetin, të drejtat dhe interesat e myslimanëve, të rrisë e zhvillojë ndjenjën e dashurisë e të besnikërisë ndaj fesë dhe atdheut, si dhe të ruajë e forcojë dialogun mes Komuniteteve Fetare në vendin tonë.

Në këtë botim të KMSH-së do të gjeni informacione rreth aktiviteteve kryesore dhe evenimenteve të ndryshme të Komunitetit Mysliman të Shqipërisë gjatë vitit 2019. Natyrisht që përfshirja e të gjithë aktivitetit të institucionit tonë, duke përfshirë myftinitë dhe institucionet arsimore-edukative, në një vëllim të tillë do të ishte e pamundur. Prandaj, institucionet arsimore dhe myftinitë kryesore të vendit e pasqyrojnë aktivitetin e tyre në botime të veçanta.

Gjejmë rastin të falënderojmë të gjithë institucionet publike dhe jopublike, brenda dhe jashtë vendit, që nuk e kanë kursyer ndihmën dhe bashkëpunimin e vazhdueshëm me Komunitetin Mysliman të Shqipërisë.

Gjithashtu shprehim gatishmërinë për të bashkëpunuar dhe për të qenë pjesë e të gjitha aktiviteteve dhe nismave në të mirë të vendit tonë dhe të shoqërisë njerëzore në përgjithësi.

Formatin e këtij botimi mund ta gjeni në faqen zyrtare të institucionit: www.kmsh.al

aktivitete

janar

Roli i gruas në shoqërinë moderne sipas këndvështrimit Islam

Komuniteti Mysliman i Shqipërisë në bashkëpunim me Këshillin Botëror të Komuniteteve Myslimane dhe Departamentin e Shkencave Islame pranë Kolegjit Universitar “Bedër”, zhvilluan Konferencën e 2-të Ndërkombëtare në Studimet Islame (ISCON), me temë: “Roli i gruas në shoqërinë moderne sipas këndvështrimit Islam”.

Kjo konferencë, e cila u zhvillua në ambientet e Kolegjit Universitar Bedër, mbledhi së bashku studiues nga vende të ndryshme të botës, akademikë, përfaqësues të institucioneve të ndryshme publike dhe private të vendit, përfaqësues të shoqërisë civile, pedagogë dhe studentë të shumtë.

Në seancën e parë, e cila përbënte njëkohësisht edhe seancën e përshëndetjeve të kësaj konference, ishin të pranishëm, H. Skender Bruçaj, Kryetar i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, znj. Loreta Aliko, Kryetare e Komitetit Shtetëror për Kultet, Prof. Dr. Ferdinand Gjana, Rektor i Kolegjit Universitar Bedër, si dhe Dr. Mohammed Bechari, Sekretar i Përgjithshëm i Këshillit Botëror të Komuniteteve Myslimane.

Konferenca u zhvillua më tej me referimin e dhjetëra temave të ndryshme që preknin aspekte të shumëllojshme të rolit të gruas sipas këndvështrimit Islam në shoqërinë e shekullit 21, të tilla si: “Kontributi patriotik, emancipues dhe kulturor i gruas myslimane në historinë e Shqipërisë”, “Divorci dhe dhuna në familje, plagë të shoqërisë moderne”, “Roli i gruas në edukimin e brezave, bazuar në revistat kulturore islame”, etj.

Në seancën e mbylljes, u shpërndanë certifikatat për të gjithë referuesit që morën pjesë me punime të ndryshme në këtë konferencë.







Drejtori i Përgjithshëm i Deutsche Welle viziton KMSH-në

Kryetari i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, z. Skender Bruçaj, priti në një takim pune Drejtorin e Përgjithshëm të Deutsche Welle, z. Peter Limbourg, i shoqëruar nga dy përfaqësues të tjerë të kësaj mediaje.

Gjatë takimit u diskutua për aspekte të ndryshme të raportimit të tematikave fetare ndër vite të kësaj mediaje si dhe për hapësirën që ka pasur institucioni i KMSH-së në raportimet e saj.

Në fjalën e tij, z. Bruçaj, pasi bëri një rezymë të shkurtër të institucionit që drejton, theksoi rëndësinë e bashkëpunimit me DW si thelbësore në mos tjetërsimin e termave fetarë në përdorimin e përditshëm të raportimeve që vijnë nga problematika fetare të vendit tonë.

Ndërsa z. Limbourg, vlerësoi punën e Komunitetit Mysliman të Shqipërisë dhe kontributin që ka ky institucion në shoqërinë tonë. Gjithashtu ai vlerësoi frymën e tolerancës fetare në Shqipëri. Në fund ai prezantoi disa nga projektet që DW ka për rajonin e Ballkanit.







Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit Botëror të Komuniteteve Myslimane, viziton KMSH-në

Kryetari i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, H. Skender Brucaj, priti në një takim pune Sekretarin e Përgjithshëm të Këshillit Botëror të Komuniteteve Myslimane, Dr. Mohammed Bechari.

Gjatë takimit, ku ishin të pranishëm edhe nënkryetarët e KMSH-së, z. Bujar Spahiu, z. Lauren Luli si dhe Dr. Jemal El Seferti, pedagog në Departamentin e Shkencave Islame në Bedër, u diskutuan aspekte të ndryshme të bashkëpunimit të deritanishëm mes dy institucioneve, përfshirë këtu edhe konferencën ndërkombëtare mbi “Rolin e gruas në shoqërinë e shekullit 21 sipas këndvështrimit Islam”, konferencë kjo e cila u zhvillua një ditë më parë si bashkëpunim i dy institucioneve të lartpërmendura dhe Kolegjit Universitar “Bedër”.

Pasi e njohu me aktivitetin e deritanishëm dhe shtrirjen funksionale të Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, z. Brucaj, u ndal në aspekte të ndryshme të jetës fetare në vendin tonë.

Nga ana e tij, Dr. Bechari, foli mbi misionin, kompetencat, parimet dhe shtrirjen e Këshillit Botëror të Komuniteteve Myslimane në 142 shtetet në të cilat operon.



aktivitete

s

shkurt

Abu Dabi: Nënshkruhet “Dokumenti i vëllazërisë njerëzore”

Shejhu i madh i Al-Az-harit, Shejh Ahmed al-Tajjib dhe Kreu i Kishës Katolike dhe sovran i qytetit të Vatikanit, Papa Françesku, nënshkruan “Dokumentin e Vëllazërisë Njerëzore”, gjatë vizitës historike që ky i fundit zhvilloi këtë muaj në kryeqytetin e Emirateve të Bashkuara Arabe, Abu Dabi.

Ky dokument u nënshkrua ndërmjet dy krerëve të lartpërmendur në fund të Konferencës Globale të Vëllazërisë Njerëzore, Abu Dabi, në prezencë të rreth 700 liderëve fetarë nga e gjithë bota, ndër ta edhe Kryetari i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, H. Skender Bruçaj. Ky dokument në vetvete fton të gjithë njerëzit që kanë besim në Zot, të bashkohen për të punuar sëbashku e për ti dhënë brezave të ardhshëm kulturën e respektit të ndërsjellë mes njerëzve që vijnë nga besime, raca apo shtresa shoqërore të ndryshme.

Ky dokument reflekton mbi nivelin e varfërisë, konfliktit dhe vuajtjes së aq shumë vëllezërve dhe motrave në pjesë të ndryshme të botës si pasojë e luftërave, padrejtësive shoqërore, korrupsionit, pabarazisë, degradimit moral, diskriminimit, ekstremizmit të dhunshëm dhe shumë faktorëve të tjerë nga të cilët po vuan shoqëria njerëzore sot.





Abu Dabi: “Zhvillon punimet Konferenca Globale e Vëllazërisë njerëzore”

Kryetari i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, H. Skender Bruçaj, mori pjesë në “Konferencën Globale të Vëllazërisë Njerëzore” me rreth 700 përfaqësues të feve të ndryshme nga e gjithë bota në Abu Dabi të Emirateve të Bashkuara Arabe, ndër të cilët veçojmë Shejhun e madh të Al-Az-harit, Shejh Ahmed al-Tajjib dhe Papa Françeskun, Kreun e Kishës Katolike dhe sovran i qytetit të Vatikanit.

Ndër tematikat kryesore të kësaj konference përmendim vlerat humane, modelin e përbashkët të tolerancës dhe bashkëjetesës ndërfetare si dhe besimin në një të ardhme të përbashkët njerëzore.

Kryetari i KMSH-së, z. Bruçaj, shoqëruar nga Nënkryetari, z. Bujar Spahiu, gjatë këtyre ditëve kanë zhvilluar disa takime me përfaqësues të tjerë fetarë, ku kanë ndarë modelin e harmonisë dhe bashkëjetesës ndërfetare të vendit tonë.



Zhvillohet konferenca “Feja dhe përshpirtëria në marrëdhëniet mes të krishterëve dhe myslimanëve”

Një reflektim teologjiko-shpirtëror mbi aktualitetin e Islamit sot, si dhe shkëmbimi i praktikave të mira për të favorizuar marrëdhëniet me myslimanët në Evropë, kanë qenë në qendër të konferencës së 5-të të delegatëve kombëtarë të Konferencave Ipeshkvnore në Evropë (CCEE), konferencë në të cilën mori pjesë edhe Kryetarja e Komitetit Shtetëror për Kultet, znj. Loreta Aliko

Në seancën e parë të referimeve, Nënkryetari i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë-së, z. Lauren Luli, portretizoi cilësitë e besimtarit mysliman dhe rolin që duhet të ketë ai në shoqëri sipas Kur'anit.

Më tej, z. Halit Akasheh, Kryetar i zyrës për Islamin pranë Këshillit Papnor për Dialogun Ndërfetar, ndau me të pranishmit përshëndetjet e Kardinalit Jean-Louis Tauran, president i këtij dikasteri në Vatikan. Ai njohu të pranishmit rreth veprimtarive të Këshillit Papnor dhe rreth Udhëtimit Apostolik të Papa Françeskut në Egjipt, që kulmoi në takimin me Shejhun e el-Ez'her-it.

Më tej, Mons. Angjelo Masafrës, Kryepeshkëv i Shkodër-Pultit shpjegoi kontributin që Shqipëria mund t'i japë Evropës në aspektin e dialogut ndërfetar.

Pas seancës së paradites delegacioni i ardhur nga Europa vizitoi xhaminë Ebu Bekër, ku janë pritur nga nënkryetari i KMSH-së, z. Lauren Luli, drejtori i Medias dhe Marrëdhënieve me Publikun, z. Agron Hoxha, përfaqësues nga Myftinia Shkodër, Imam Lavdrim Hamja dhe imami i xhamisë Idmir Plaku.



aktivitete

mars

H. Bujar Spahiu zgjidhet Kryetar i Ri i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë

02/03/2019 - Këshilli i Përgjithshëm i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë zhvilloi mbledhjen e tij të zakonshme për zgjedhjen e kryetarit të ri të institucionit. Pas votimit të myftinjve të rretheve, anëtarëve të kryesisë së KMSH-së dhe anëtarëve të Këshillit të Përgjithshëm, z. Bujar Spahiu, u zgjodh Kryetari i Ri i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë me një mandat 5-vjeçar. Pas përfundimit të mandatit të Kryetarit Bruçaj, kandidaturat për kryetar të KMSH-së ishin: Nënkryetari i institucionit, z. Bujar Spahiu, Myftiu i Tiranës, z. Ylli Gurra, Kryetari i Këshillit të Përgjithshëm të KMSH-së, z. Islam Hoxha, Myftiu i Lushnjes, z. Gramoz Blliku ndërsa kryetari aktual z. Skender Bruçaj njoftoi një ditë më parë tërheqjen e tij nga kandidimi për një mandat të dytë. Kryetari në detyrë, H. Skender Bruçaj në fjalën e tij të rastit u shpreh se ndihet i vlerësuar për besimin që i'u dha duke shërbyer si Kryetar i institucionit në 5 vitet që lamë pas. Ndërsa kandidatët e tjerë prezantuan platformat dhe vizionin e tyre për të ardhmen e institucionit. Nga 90 anëtarë të Këshillit votuan 87 prej tyre, pasi 3 anëtarë mungonin. Fitues me shumicë votash u shpall z. Spahiu me 59 vota. Ndërsa dy kandidatët e tjerë, z. Ylli Gurra mori 26 vota dhe z. Gramoz Blliku 2 vota.

Procesi i votimit shkoi rregullisht dhe nuk pati asnjë kontestim.

Ish-Kryetari Bruçaj i dorëzoi në shenjë simbolike Kryetarit të ri çallmën dhe xhyben e tij, duke i uruar suksese dhe mbarësi në këtë mandat pesëvjeçar. Më pas, z. Spahiu me dorë mbi Kur'an bëri betimin konform statutit përpara anëtarëve të Këshillit të Përgjithshëm, si vijon: "Betohe me emër të Allahut, se do të vazhdoj me besnikëri e përkushtim urdhrat e Islamit, do të punoj me ndërgjegje të plotë islame për lartësimin e fesë së Allahut, do të zbatoj me përpikmëri Statutin dhe Rregulloren e Komunitetit Mysliman, dhe do të punoj me ngulm për forcimin e ndjenjës kombëtare e atdhdashurisë ndër myslimanët e Republikës së Shqipërisë. Allahu më ndihmoftë!"








H. Skender Bruçaj uron kryetarin e ri të KMSH-së

Kryetari i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, H. Bujar Spahiu mori në mënyrë simbolike detyrën nga paraardhësi i tij në këtë post, H. Skender Bruçaj. Z. Bruçaj përcolli urimet më të mira dhe të sigërtë për Kryetarin e Ri të Komunitetit Mysliman, duke shprehur dëshirën dhe bindjen për sukses në misionin e rëndësishëm që kjo detyrë e lartë dhe e nderuar kërkon në shërbim të besimtarëve dhe shoqërisë shqiptare.

Kryetari i KMSH-së, H. Bujar Spahiu shprehu falënderimet dhe mirënjohjen ndaj z. Bruçaj për kontributin e tij në krye të KMSH-së për 5-vjeçarin që lam pas dhe e siguroi që KMSH në drejtimin e tij do të punojë fort për promovimin e Islamit në Shqipëri dhe më gjerë, për të çuar në zemrën e çdo njeriu mesazhin paqësor të Islamit, duke promovuar vlerat më të larta të besimit dhe mbrojtjen e parimeve të shëndosha mbi të cilat duhet të ndërtohet një shoqëri.





Kreu i Kryegjyshatës Botërorë Bektashiane uron Kryetarin e KMSH-së

Kryetari i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, H. Bujar Spahiu priti në një takim urimi kreun e Kryegjyshatës Botërore Bektashiane, H. Dede Edmond Brahimaj.

H. Dede Edmond Brahimaj i uroi suksese Kryetarit Spahiu në misionin e tij fisnik në shërbim të besimtarëve, atdheut dhe kombit. Gjithashtu ai vlerësoi kontributin e Komunitetit Mysliman në gjithë këto vite, dhe shprehu bindjen së në drejtimin e z. Spahiu, institucioni do ta lartësojë edhe më tej traditën shekullore në shërbim të besimit.

Z. Spahiu nga ana e tij e siguroi se bashkëpunimi i ndërsjellë me Kryegjyshatën Botërore Bektashiane do të jetë i shkëlqyer për t'u angazhuar në respektin e ndërsjellë, bashkëpunimin në fushat sociale dhe në dialogun aktiv midis komuniteteve dhe mbarë shoqërisë, me qëllim ruajtjen dhe promovimin e vlerave morale, etike dhe kulturore.



Kreu i KMSH-së pret në një takim kryetaren e Komitetit Shtetëror për Kultet

Kryetari i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, H. Bujar Spahiu, priti në selinë e institucionit kryetaren e Komitetit Shtetëror për Kultet, znj. Loreta Aliko dhe anëtarin e KSHK-së, z. Servet Gurra, i cili ndjek marrëdhëniet me KMSH-në.

Znj. Aliko theksoi bashkëpunimin e ngushtë mes institucionit që ajo përfaqëson dhe Komunitetit Mysliman të shqipërisë, shprehu gatishmërinë për intensifikimin e marrëdhënieve të mëtejshme, si dhe i uroi kreut të KMSH-së, suksese e mbarësi në udhëheqjen e institucionit.

Ndërsa Kryetari Spahiu, shprehu falënderimet ndaj znj. Aliko për urimin dhe e siguroi se bashkëpunimi ndërinstitutional do të jetë i vazhdueshëm.





Nunci Apostolik në Shqipëri viziton Kryetarin e KMSH-së

Kryetari i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, H. Bujar Spahiu, priti në selinë e institucionit Nuncin Apostolik në Shqipëri, z. Charles John Brown. Nunci Apostolik në Shqipëri i uroi kreut të KMSH-së suksese e mbarësi në udhëheqjen dhe drejtimin e Komunitetit Mysliman të Shqipërisë dhe i përcolli atij urimet e Papa Francheskut nga Vatikani. Ai vlerësoi punën dhe angazhimin e treguar nga KMSH në raport me bashkësitë e tjera fetare dhe ruajtjen e këtij aseti të çmuar, duke shprehur gatishmërinë për t'i forcuar marrëdhëniet dhe bashkëpunimin në ruajtjen e vlerave dhe harmonisë ndërfetare.

Kreu i KMSH-së shprehu angazhimin e tij për të bashkëpunuar me të gjithë organizmat të cilat i shërbejnë mbarëvajtjes së harmonisë ndërfetare si dhe ndikojnë pozitivisht në kohezionin social të Shqipërisë.





Kryetari i Konferencës Ipeshkvore të Shqipërisë uron kreun e KMSH-së

Kryetari i Konferencës Ipeshkvore të Shqipërisë, Arqipeshkvi i Tiranë – Durrës, Imzot George Frendo uroi Kryetarin e Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, H. Bujar Spahiun me rastin e zgjedhjes së tij në krye të këtij institucioni gjatë vizitës së sotme që Imzot George Frendo së bashku me Sekretarin e përgjithshëm të Kishës Katolike, Don Henry, zhvilluan në selinë e KMSH-së.

Gjatë bashkëbisedimit, Imzot George Frendo, vlerësoi punën e deritanishme të Komunitetit Mysliman të Shqipërisë në ruajtjen dhe forcimin e harmonisë dhe dialogut ndërfetar në Shqipëri. Ai vlerësoi gjithashtu vendosmërinë e Kryetarit Spahiun për ta vazhduar më tej këtë traditë.

Më tej, Kryetari i KMSH-së z. Spahiun, pasi i falënderoi të pranishmit për vizitën dhe urimet e tyre për zgjedhjen e tij si kryetar të këtij institucioni, i inkurajoi ata për ta vazhduar më tej frymën e bashkëpunimit ndërmjet institucioneve të tjera fetare në të mirë të shoqërisë në të cilën jetojmë.

Bashkëbisedimi ndërmjet tyre vazhdoi më tej duke prekur një sërë tematikash të ndryshme të aktualitetit në vendin tonë.





Medreseja e Tiranës uron kreun e KMSH-së për detyrën e re

Kryetari i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, H. Bujar Spahiu, priti në një takim drejtorin e Medresesë së Tiranës, z. Ali Zaimi, një pjesë të stafit pedagogjik dhe disa nxënës të medresesë.

Drejtori i Medresesë së Tiranës, z. Zaimi bashkë me stafin dhe nxënëset uruan kryetarin e KMSH-së për detyrën e tij fisnike në shërbim të fesë, edukimit, arsimit dhe vlerave më të larta njerëzore.

Kryetari Spahiu, pasi i falënderoi për urimet u shpreh se KMSH do t'i kushtojë një vëmendje të rëndësishme medreseve në mbarë vendin, që të mundësohet shkollim në kushte bashkëkohore dhe me cilësi të lartë në mësimdhënie.





Kryetari i KMSH-së takim me myftiun dhe imamët e Fierit

Kryetari i Komunitetit Mysliman, H. Bujar Spahiu, priti në një takim imamët e Myftinisë së Fierit së bashku me Myftiun, z. Taulant Bica, dhe ish myftiun e këtij qyteti, z. Karafil Mane.

Kryetari Spahiu i falënderoi imamët për kontributin e tyre të vyer dhe theksoi se KMSH do të jetë në mbështetje të tyre në mënyrë që kumtimi i Islamit të jetë në formën më të mirë të mundshme.

Myftiu i Fierit, z. Bica, dhe imamët i uruan suksese Kryetarit Spahiu në misionin e tij fisnik në shërbim të besimtarëve.

Gjithashtu gjatë takimit u diskutuan çështje të ndryshme mbi mënyrat dhe përmirësimin e shërbimit ndaj besimtarëve, mbi punën e tyre të përditshme të imamëve, marrëdhëniet me besimtarët, etj.



Kryetari i KMSH-së pret në takim ambasadorin e Austriës

Kryetari i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë H. Bujar Spahiu priti në një takim Ambasadorin e Republikës së Austriës në Shqipëri, z. Johann Sattler.

Ambasadori Sattler uroi kreun e KMSH-së për detyrën dhe shprehu gatishmërinë për të kontribuar në kuadër të forcimit të harmonisë fetare në Shqipëri. Kreu i KMSH-së dhe ambasadori vlerësuan marrëdhëniet e mira të deritanishme dhe biseduan mbi projekte të përbashkëta në të ardhmen, konkretisht në organizimin e një konference gjatë këtij viti.

Kujtojmë se Ambasada e Austriës, KMSH dhe komunitetet e tjera fetare në bashkëpunim me njëra-tjetrën organizuan vitin e kaluar Konferencën Ndërkombëtare rreth Dialogut Ndërfetar, me temë: “Shqipëria, model i bashkëjetesës ndërfetare për Europën”.

Kreu i KMSH-së e falënderoi ambasadorin për urimet dhe për bashkëpunimin e ngushtë mes institucioneve dhe shprehu gatishmërinë për organizimin e projekteve të tjera të përbashkëta.





Kreu i KMSH-së pret në takim kryetarin e BFI të RMV, H. Sulejman ef. Rexhepin

Kryetari i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë H. Bujar Spahiu priti në një takim Kryetarin e Bashkësisë Fetare Islame të Republikës së Maqedonisë së Veriut, H. Sulejman ef. Rexhepi bashkë me një delegacion të këtij institucioni, Prof. Dr. Qani Nesimi, H. Shaqir Fetahu, Mr. Qenan Ismaili dhe z. Muzemil Osmani.

Kryetari i KMSH-së i falënderoi për vizitën dhe vlerësoi rolin e jashtëzakonshëm që luan Bashkësia Fetare Islame në Maqedoninë e Veriut në të gjitha fushat në të cilat ushtron aktivitetin.

Kryetari i BFI të RMV bashkë me stafin e tij përcollën urimet më të mira për detyrën fisnike të kryetarit të KMSH-së, me bindjen e plotë se bashkëpunimi midis dy institucioneve do të jetë i vazhdueshëm dhe i frytshëm në të mirë të Islamit në Shqipëri, Maqedoninë e Veriut dhe më gjerë.

Kryetari Spahiu shprehu falenderimet dhe mirënjohjet e tij për urimet dhe fjalët e përzemërta. Kreu i KMSH-së e siguroi H. Sulejman ef. Rexhepin se bashkëpunimi midis dy institucioneve do të jetë i vazhdueshëm dhe do të shtrihet në shumë fusha të tjera.











Kryetari i KMSH-së pret në një takim Myftiun dhe imamët e Shkodrës

Kryetari i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, H. Bujar Spahiu, priti në një takim imamët e Myftinisë së Shkodrës me në krye Myftiun, z. Muhamed Sytari. Myftiu, z. Sytari, sëbashku me imamët e kësaj myftinie, shprehën urimet e tyre për zgjedhjen e z. Spahiu si kryetar të komunitetit si dhe i uruan atij suksese në misionin fisnik në shërbim të besimtarëve myslimanë shqiptarë.

Nga ana e tij Kryetari i KMSH-së, z. Spahiu, e falënderoi myftiun dhe imamët për kontributin e tyre të vyer në shërbim të Islamit.

Bashkëbisedimi me ta vazhdoi më tej duke prekur një sërë tematikash aktuale në lidhje me myftininë e rrethit Shkodër. Në fund të takimit Kryetari i KMSH-së z. Spahiu dhe Myftiu i Shkodrës z. Sytari shkëmbyen disa dhurata simbolike ndërmjet tyre.



Kreu i KMSH-së pret në një takim drejtues të AIITC-së

Kryetari i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, H. Bujar Spahiu, priti në selinë e institucionit drejtues të Institutit Shqiptar të Mendimit dhe të Qytetërimit Islam, drejtorin, Dr. Ardian Muhaj, nëndrejtorin, z. Alban Kodra, kryetarin e Bordit Drejtues, z. Faruk Borova dhe përgjegjësin e departamentit me jashtë, z. Ubejd Osmani.

Drejtori i AIITC-së bashkë me përfaqësuesit e pranishëm uruan kreun të KMSH-së për suksese e mbarësi në udhëheqjen dhe drejtimin e Komunitetit Mysliman të Shqipërisë.

Gjatë takimit u diskutua mbi projekte të përbashkëta dhe veprimtari të dobishme sociale, edukative, fetare e bamirësie në shërbim të Islamit, kulturës dhe vlerave të tij.

Kreu i KMSH-së shprehu falënderimet ndaj drejtuesve të institucionit për urimet dhe shtoi se bashkëpunimi i frytshëm me AIITC do të vazhdojë në shumë fusha të ndryshme.





Myftinia e Elbasanit uron kreun e KMSH-së

Myftiu i Elbasanit, z. Agim Duka, i shoqëruar nga përfaqësues të tjerë të Myftinisë dhe anëtar i Këshillit të përgjithshëm, z. Arben Ramkaj, si dhe Nënkryetari i Bashkisë Elbasan, z. Ervin Saraçi, vizituan Kryetarin e Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, z. Bujar Spahiu, me rastin e zgjedhjes së tij në krye të këtij institucioni.

Në fjalën e tyre ata e uruan z. Spahiu për zgjedhjen si kryetar të KMSH-së dhe e siguruan atë për vazhdimësinë e kontributit në myftininë e këtij rrethi. Nga ana e tij, Kryetari Spahiu i falënderoi ata për vizitën dhe u ndal në diskutimin e tematikave të ndryshme në lidhje me këtë myftini.

Në fund të takimit, përfaqësuesit e Myftinisë së Elbasanit i dhuruan, z. Spahiu, simbolikën e qytetit të Elbasanit.




Kryetari i KMSH-së takim me myftinitë e Korçës, Pogradecit dhe Devollit

Kryetari i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, H. Bujar Spahiu, priti në një takim Myftiun e Korçës, z. Ledian Cikalleshi, Myftiun e Pogradecit, z. Namik Mahmutllari, Myftiun e Devollit, z. Artur Vrenozi si dhe imamët e qyteteve respektive.

Kryetari i KMSH-së i falënderoi myftinjtë dhe imamët për kontributin e tyre të vyer dhe theksoi se KMSH do të jetë në mbështetje të tyre në mënyrë që kumtimi i Islamit të jetë në formën më të mirë të mundshme. Më tej ai i inkurajoi imamët të vazhdojnë punën e tyre në përhapjen e mesazhit të drejtë të Islamit dhe përcjelljen e vlerave morale dhe shoqërore.

Myftinjtë dhe imamët i uruan suksese Kryetarit Spahiu në misionin e tij fisnik në shërbim të besimtarëve.

Gjithashtu gjatë takimit u diskutuan çështje të ndryshme mbi mënyrat dhe përmirësimin e shërbimit ndaj besimtarëve, punën e përditshme në këto myftini etj.





Myftinia e Kukësit viziton kreun e KMSH-së

Myftiu i Kukësit, z. Islam Hoxha, i shoqëruar nga imamët e këtij rrethi, vizituan Kryetarin e Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, H. Bujar Spahiu, me rastin e zgjedhjes së tij në krye të institucionit.

Gjatë vizitës ata shkëmbyen mendime të ndryshme rreth punës së përditshme të imamëve në rrethin e Kukësit si dhe uruan Kreun e KMSH-së për zgjedhjen e tij në krye të institucionit, duke shprehur dëshirën për një mandat sa më frytdhënës në të mirë të besimtarëve myslimanë.

Kryetari, z. Spahiu, i falënderoi ata për vizitën dhe urimet si dhe shprehu vlerësimet e tij për punën e përditshme të imamëve, Myftiut apo të gjithë atyre që kontribuojnë në të mirë të Islamit në rrethin e Kukësit.





Kryetari i KMSH-së pret në një takim ambasadorin e Kuvajtit

Kryetari i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, z. Bujar Spahiu, priti në një vizitë në selinë e KMSH-së ambasadorin e shtetit të Kuvajtit në Shqipëri, z. Fayez Mishari Al-Jassim.

Kryetari Spahiu e falënderoi z. Fayez Mishari Al-Jassim për vizitën dhe vlerësoi marrëdhëniet e mira midis dy palëve dhe shprehu gatishmërinë për bashkëpunim që këto marrëdhënie të forcohen akoma më shumë.

z. Al-Jassimi, e uroi z. Spahiu për detyrën e re dhe vlerësoi punën që KMSH ka dhënë dhe vazhdon të japë si për komunitetin e besimtarëve, ashtu edhe për shoqërinë shqiptare në tërësi.





Kreu i KMSH-së takim me myftiun dhe imamët e Beratit

Kryetari i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, H. Bujar Spahiu, priti në një takim Myftiun e Beratit, z. Baftjar Këllezi dhe imamët e kësaj myftinie. Bashkëbisedimi ndërmjet tyre u përqendrua në aktualitetin e myftinisë së këtij qyteti. Më tej, myftiu z. Këllezi dhe imamët pjesëmarrës e uruan Kryetarin e KMSH-së për zgjedhjen e tij në krye të institucionit dhe e siguruan atë për kontributin e mëtejshëm në shërbim të besimtarëve myslimanë të këtij qyteti. Kryetari i KMSH-së i falënderoi për vizitën dhe urimet e përzemërta dhe u shpreh entuziast për të vijuar më tej punën në shërbim të islamit, kulturës dhe vlerave të tij.





Drejtori i Qatar Charity viziton Kreun e KMSH-së

Kryetari i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, H. Bujar Spahiu, priti në një takim drejtorin e Qatar Charity në Shqipëri, z. Shawki Abou Seif.

Drejtori i Qatar Charity e uroi kreun e KMSH-së për suksese e mbarësi në udhëheqjen dhe drejtimin e Komunitetit Mysliman të Shqipërisë.

Gjatë takimit u diskutua mbi projekte të përbashkëta dhe veprimtari të dobishme sociale, edukative, fetare e bamirësie në shërbim të Islamit, kulturës dhe vlerave të tij.

Kreu i KMSH-së shprehu falënderimet ndaj z. Shawki Abou Seif për urimet dhe shtoi se bashkëpunimi i frytshëm me Qatar Charity do të vazhdojë në shumë fusha të ndryshme.



KMSH-Bedër, promovojnë librin “Argumentet bazë të Fikhut Hanefi”

Drejtorja e Kulturës në Komunitetin Mysliman të Shqipërisë, në bashkëpunim me Departamentin e Shkencave Islame në KU Bedër, promovuan librin me titull: “Argumentet bazë të Fikhut Hanefi”.

Aktiviteti u çel me fjalën përshëndetëse të Dr. Gentë Kruja, Përgjegjës i Departamentit të Shkencave Islame. Më pas fjalën e mori Drejtori i Kulturës dhe Arsimit në KMSH, z. Dorian Demetja, i cili foli për domosdoshmërinë e këtij botimi, duke bërë një përshkrim të përgjithshëm rreth zhvillimit të fesë në Shqipëri pas viteve 90’, ku dhe ceku problematikat që u importuan në vendin tonë në drejtim të praktikave fetare.

Në këtë aktivitet i ftuar special ishte z. Redin Quku, myfti i Durrësit. Z. Quku, analizoi veprën në mënyrë të detajuar, duke cekur edhe çështjet të cilat sot konsiderohen si problematike dhe jo lehtë të kuptueshme për masën e gjerë. Ai sqaroi disa aspekte të taklidit, që janë keqkuptuar dhe shtrembëruar rëndë, duke hedhur dritë mbi domosdoshmërinë, historinë dhe rolin e tij në botën e sotme.





Bashkësia Islame për Preshevën, Bujanovcin dhe Medvegjën vizitojnë KMSH-në

Kryetari i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, H. Bujar Spahiu, priti në një vizitë në selinë e KMSH-së, Kreun e Bashkësisë Islame për Preshevën, Bujanovcin dhe Medvegjën (BIPBM), Myftiun e nderuar Nexhmedin ef. Saqipi, i shoqëruar nga përfaqësues të shoqërisë civile dhe pjesëtar të tjerë të kabinetit të tij.

Pasi shprehën urimet e tyre për zgjedhjen e z. Spahiu në krye të institucionit, Kryetari i Bashkësisë Islame të Luginës së Preshevës, bëri një prezantim të gjendjes aktuale veçanërisht të besimtarëve dhe shqiptarëve të Luginës.

Në takim u diskutua edhe për bashkëpunim në fusha të ndryshme, arsim, tekste shkollore, libra fetarë e vizita të ndërsjella.

Nga ana e tij, Kryetari Spahiu i falënderoi për vizitën dhe urimet me rastin e zgjedhjes së tij në krye të KMSH-së, si dhe shprehu vullnetin e tij që marrëdhëniet e mira ndërmjet dy institucioneve fetare të intensifikohen më tej në të mirë të Islamit dhe besimtarëve myslimanë brenda dhe jashtë kufijve të Shqipërisë.

Në fund të takimit ata shkëmbyen disa dhurata simbolike ndërmjet tyre.





Kreu i KMSH-së takim me Koordinatorin Kombëtar për Parandalimin e Ekstremizmit të Dhunshëm

Kryetari i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, H. Bujar Spahiu, priti në një takim Koordinatorin Kombëtar për Parandalimin e Ekstremizmit të Dhunshëm, z. Agron Sojati.

Z. Sojati, e uroi kreun e KMSH-së për suksese e mbarësi në udhëheqjen dhe drejtimin e Komunitetit Mysliman të Shqipërisë dhe vlerësoi bashkëpunimin ndërinstitucional të deritanishëm.

Kreu i KMSH-së, z. Spahiu e falënderoi për urimin dhe e garantoi së bashkëpunimi me Koordinatorin Kombëtar për Parandalimin e Ekstremizmit të Dhunshëm do të intensifikohet edhe më tej.

Gjithashtu, z. Spahiu, shprehu qartazi qëndrimin e institucionit për radikalizmin dhe ekstremizmin e dhunshëm.





Kryetari i KMSH-së takim me myftiun dhe imamët e Krujës

Kryetari i Komunitetit Mysliman, H. Bujar Spahiu, priti në një takim imamët e Myftinisë së Krujës së bashku me Myftiun, z. Erjol Haxhiu.

Kryetari i KMSH-së i falënderoi imamët për kontributin e tyre të vyer dhe theksoi se KMSH do të jetë në mbështetje të tyre në mënyrë që suksesi në kumtimin e Islamit të jetë sa më i madh.

Myftiu i Krujës, z. Haxhiu dhe imamët i uruan suksese Kryetarit Spahiu në misionin e tij fisnik në shërbim të besimtarëve.

Gjithashtu gjatë takimit u diskutuan çështje të ndryshme mbi mënyrat dhe përmirësimin e shërbimit ndaj besimtarëve.



Kryetari Spahiu pret në një takim Ambasadorin e Hungarisë

Kryetari i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, z. Bujar Spahiu, priti në një vizitë në selinë e institucionit Ambasadorin e Hungarisë në Shqipëri, z. Lóránt Balla.

Kryetari Spahiu, e falënderoi z. Lóránt Balla për vizitën dhe e njohu atë me historikun e KMSH-së, ecurinë dhe sfidat e hasura, si dhe kontributin në fusha të ndryshme me interes shoqëror.

Gjatë takimit u vlerësua bashkëpunimi mes palëve dhe u diskutua mundësia e thellimit të tij në të ardhmen nëpërmjet projekteve konkrete në fusha të ndryshme kulturore, sociale dhe edukative.

Ambasadori e uroi z. Spahiu për detyrën e re dhe vlerësoi lart punën dhe kontributin që KMSH ka dhënë dhe vazhdon të japë si për komunitetin e besimtarëve, ashtu edhe për shoqërinë shqiptare në tërësi.







Kryetari i KMSH-së pret në një takim myftiun dhe imamët e Sarandës

Myftiu i Sarandës, z. Bledar Mullaj, i shoqëruar nga imamët e kësaj myftinie, vizituan Kryetarin e Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, H. Bujar Spahiu, me rastin e zgjedhjes së tij në krye të këtij institucioni.

Z. Mullaj, e uroi Kryetarin Spahiu në udhëheqjen dhe drejtimin e Komunitetit Mysliman të Shqipërisë dhe vlerësoi bashkëpunimin e deritanishëm me myftininë e Sarandës, për të vazhduar më tej me diskutimin e një sërë tematikash në lidhje me zhvillimin e mëtejshëm të kësaj myftinie.

Nga ana e tij, Kreu i KMSH-së, i falënderoi ata për urimet dhe vizitën si dhe ju uroi atyre punë të mbarë në mbarëvajtjen e punëve të përditshme në shërbim të Islamit dhe besimtarëve të qytetit të Sarandës.





Kryetari i KMSH-së takim me myftiun dhe imamët e Vlorës

Kryetari i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, H. Bujar Spahiu, priti në një takim Myftiun e Vlorës z. Bilal Bodlli dhe imamët e kësaj myftinie. Bashkëbisedimi ndërmjet tyre u përqendrua në aktualitetin e myftinisë së këtij qyteti. Kryetari i KMSH-së i falënderoi imamët për kontributin e tyre të vyer dhe theksoi se KMSH do të jetë në mbështetje të tyre vazhdimisht. Më tej, myftiu z. Bodlli dhe imamët pjesëmarrës e uruan Kryetarin e KMSH-së për zgjedhjen e tij në krye të institucionit dhe e siguruan atë për kontributin e mëtejshëm në shërbim të besimtarëve myslimanë të rethit.





Myftinia e Peqinit viziton Kreun e KMSH-së

Kryetari i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, H. Bujar Spahiu, priti në një takim në selinë e institucionit, Myftininë e Peqinit, të përfaqësuar nga Myftiu, z. Mensur Rrapanji dhe imamët përkatës. Gjatë takimit ata e uruan z. Spahiu për detyrën e re në krye të KMSH-së, si dhe shtruan për diskutim tematika të ndryshme me nevojat dhe zhvillimet aktuale të kësaj myftinie.

Nga ana e tij, kryetari i komunitetit i falënderoi ata për urimet, vizitën dhe kontributin e vazhdueshëm në punën e tyre si dhe shprehu vullnetin e tij të plotë për të vazhduar më tej punën në shërbim të Islamit dhe besimtarëve myslimanë të kësaj myftinie.





Kreu i KMSH-së pret në takim drejtorin e Fondacionit “Mirënjohja për Evropën dhe Ballkanin”

Kryetari i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, H. Bujar Spahiu, priti në një takim drejtorin e fondacionit “Mirënjohja për Evropën dhe Ballkanin”, z. Mahmoud el-Nexhdi.

Drejtori i fondacionit “Mirënjohja për Evropën dhe Ballkanin” e uroi kreun e KMSH-së për suksese e mbarësi në drejtimin e Komunitetit Mysliman të Shqipërisë.

Gjatë takimit u bisedua mbi projekte të përbashkëta dhe veprimtari të dobishme sociale, edukative, fetare e bamirësie në shërbim të Islamit, kulturës dhe vlerave të tij.

Kreu i KMSH-së, shprehu falënderimet e tij ndaj z. Mahmoud el-Nexhdi për urimet dhe shtoi se bashkëpunimi i frytshëm me Fondacionit Mirënjohja do të vazhdojë në shumë fusha të ndryshme.



Myftinia e Dibrës, Bulqizës dhe ajo e Matit urojnë kreun e KMSH-së

Kryetari i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, H. Bujar Spahiu, priti në një vizitë në selinë e institucionit Myftiun e Dibrës, z. Muis Kurtulla, Myftiun e Bulqizës, z. Sejdin Strazimiri, Myftiun e Matit, z. Valdrin Mera dhe imamët përkatës të këtyre myftinive.

Gjatë vizitës, myftinjtë dhe imamët e pranishëm shprehën urimet e tyre për zgjedhjen e z. Spahiu në krye të Komunitetit Mysliman të Shqipërisë. Më tej ata diskutuan mbi çështje të ndryshme të myftinive dhe xhamive përkatëse duke vënë theksin mbi rëndësinë e bashkëpunimit të ndërsjellë midis KMSH-së dhe myftinive në rrethe.

Nga ana e tij, Kryetari Spahiu i falënderoi të pranishmit për vizitën dhe urimet e tyre të singerta me rastin e zgjedhjes së tij në krye të institucionit dhe i siguroi ata për vazhdimësinë e marrëdhënies së ngushtë ndërmjet KMSH-së dhe myftinive në rrethe në të mirë të Islamit dhe besimtarëve myslimanë.



Myftinia Pukë viziton kryetarin e KMSH-së

Myftiu i Pukës, z. Gëzim Kopani, i shoqëruar nga imamët e kësaj myftinie vizituan selinë e Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, ku uruan kryetarin e ri, H. Bujar Spahiu, për zgjedhjen e tij në krye të institucionit.

Bashkëbisedimi i tyre u përqendrua kryesisht në zhvillimet e deritanishme të kësaj myftinie, si në aspektin menaxherial po ashtu edhe në angazhimin e përditshëm të imamëve në funksion të Islamit dhe besimtarëve myslimanë të rrethit Pukë.

Në fjalën e tij, Kryetari Spahiu, pasi i falënderoi myftiun dhe imamët e pranishëm për vizitën dhe urimet me rastin e zgjedhjes së tij në krye të KMSH-së, theksoi rëndësinë e angazhimit të vazhdueshëm të të gjithë faktorëve për të kontribuar më tej në të mirë të Islamit dhe besimtarëve të kësaj zone.



Ambasadorja e Gjermanisë në Tiranë viziton KMSH-në

Kryetari i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, H. Bujar Spahiu, priti në sëlinë e institucionit Ambasadoren e Gjermanisë në Shqipëri, znj. Susanne Schütz, sëbashku me Sekretarin e Parë, z. Enrico Günther.

Pasi uroi kryetarin e KMSH-së për zgjedhjen e tij në këtë detyrë, znj. Schütz, vlerësoi bashkëpunimin e deritanishëm të të dy institucioneve në çështje të ndryshme, si ato fetare, sociale, kulturore dhe humanitare. Po ashtu ajo theksoi gatishmërinë e institucionit që ajo përfaqëson për ta vazhduar më tej këtë bashkëpunim në të mirë të shoqërisë tonë të përbashkët.

Nga ana e tij, Kryetari Spahiu, pasi i falënderoi të pranishmit për vizitën dhe urimet që ata i përcollën u ndal në rolin dhe rëndësinë e institucionit që ai drejton në stabilitetin e shoqërisë, aktivitetin e deritanishëm të KMSH-së etj.

Bashkëbisedimi ndërmjet tyre vazhdoi më tej mbi tematika të ndryshme të zhvillimeve në vend.







Myftinia e Gjirokastrës viziton kryetarin e KMSH-së

Myftiu i Gjirokastrës, z. Armand Islami, i shoqëruar nga imamët e xhamive të kësaj myftinie vizituan Kryetarin e Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, H. Bujar Spahiun, me rastin e zgjedhjes së tij në krye të këtij institucioni.

Në fjalën e tij, myftiu, z. Islami dhe imamët e pranishëm u ndalën në diskutimin e aktualitetit të myftinisë së Gjirokastrës, aktivitetit të deritanishëm si dhe projekteve afatgjata në shërbim të besimtarëve të zonës. Më tej, ata uruan z. Spahiu për zgjedhjen e tij në krye të KMSH-së.

Ndërsa z. Spahiu, pasi i falënderoi ata për vizitën dhe urimet u ndal në rëndësinë e bashkëpunimit ndërmjet KMSH-së dhe myftinive në rrethe, në përmbushjen e misionit të përbashkët në shërbim të Islamit.





Myftinia e Lushnjës viziton kryetarin e KMSH-së

Myftiu i Lushnjës, z. Gramos Blliku, i shoqëruar nga imamët dhe përfaqësues të tjerë të kësaj myftinie, vizituan Kryetarin e Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, H. Bujar Spahiun, me rastin e zgjedhjes së tij në këtë detyrë.

Pasi i përcollën urimet për detyrën e re, myftiu z. Blliku, dhe të pranishmit e tjerë diskutuan mbi tematika të ndryshme të myftinisë dhe besimtarëve të Lushnjës.

Ndërsa Kryetari Spahiu në fjalën e tij, pasi i falënderoi të pranishmit për vizitën u ndal në rolin e imamat në shoqërinë ku bën pjesë, misionin e tij në shërbim të Islamit dhe besimtarëve myslimanë si dhe rëndësinë e bashkëpunimit me institucionin nga i cili varet. Bashkëbisedimi ndërmjet tyre vazhdoi më tej mbi një sërë tematikash aktuale të zhvillimeve jo vetëm në myftininë e Lushnjës por edhe më gjerë.





Myftiu i Gramshit dhe ai i Përmetit vizitojnë kryetarin e KMSH-së

Myftiu i Gramshit, z. Armand Asllani dhe Myftiu i Përmetit, z. Avni Goma, vizituan Kryetarin e Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, H. Bujar Spahiun, me rastin e zgjedhjes së tij në krye të institucionit.

Gjatë bashkëbisedimit ata prekën një sërë tematikash të ndryshme administrative, fetare, kulturore dhe sociale të myftinive përkatëse si dhe i shprehën z. Spahiur urrejtet e tyre për detyrën e re. Nga ana e tij, Kryetari Spahi, pasi i falënderoi ata për vizitën dhe ju uroi atyre punë të mbarë në përgjegjësitë e tyre, shprehu rëndësinë e bashkëpunimit të institucionit të KMSH-së dhe myftinive të rretheve në shërbim të Islamit dhe besimtarëve myslimanë të vendit tonë.





Departamenti i Shkencave Islame në Bedër viziton Kreun e KMSH-së

Pedagogë dhe studentë të Departamentit të Shkencave Islame pranë Kolegjit Universitar Bedër, vizituan Kryetarin e Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, H. Bujar Spahiu, me rastin e zgjedhjes së tij në krye të këtij institucioni.

Në fjalën e tij, Përgjegjësi i Departamentit, Dr. Genti Kruja, vlerësoi bashkëpunimin e deritanishëm me KMSH-në dhe u ndal në aktualitetin e studentëve, stafit dhe aktivitetit të departamentit ndër vite. Më tej, pedagogët dhe studentët e pranishëm në këtë takim uruan z. Spahiu për detyrën e re në shërbim të besimtarëve myslimanë dhe Islamit në vendin tonë. Nga ana e tij, Kryetari Spahiu shprehu gatishmërinë e plotë për të kontribuar më tej në forcimin e marrëdhënies ndërmjet Departamentit të Shkencave Islame dhe institucionit që ai përfaqëson.





Rektori i KU “Bedër” viziton kryetarin e KMSH-së

Kryetari i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, H. Bujar Spahiu, priti në një takim Rektorin e Kolegjit Universitar “Bedër”, Prof. Dr. Ferdinand Gjana, sëbashku me përfaqësues të tjerë të lartë të këtij institucioni.

Bashkëbisedimi ndërmjet tyre preku një sërë tematikash të ndryshme në lidhje me ecurinë e deritanishme të KU “Bedër” si dhe bashkëpunimet e ardhshme ndërmjet të dy institucioneve në fushën e arsimit të lartë. Më tej, Rektori Prof. Gjana dhe të pranishmit e tjerë e uruan kreun e KMSH-së, z. Spahiu, për zgjedhjen e tij në krye të institucionit. Nga ana e tij, z. Spahiu, pasi i falënderoi të pranishmit për vizitën dhe urimet, shprehu gatishmërinë e tij për të vazhduar më tej bashkëpunimin me KU Bedër, si institucioni më i lartë arsimor i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë.





Kryetari i Tarikatit “Rifai” viziton kreun e KMSH-së

Kryetari i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, H. Bujar Spahiu, priti në një takim Kryetarin e Tarikatit “Rifai”, Sheh Qemaludin Reka.

Pasi i shprehu urimet kreut të KMSH-së me rastin e zgjedhjes së tij në krye të institucionit, z. Reka, u ndal në marrëdhënien e deritanishme të tarikatit që ai përfaqëson dhe Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, duke e vënë theksin mbi unitetin dhe bashkëpunimin dypalësh.

Kryetari Spahiu e falënderoi z. Reka për vizitën dhe urimet dhe shprehu gatishmërinë e tij për zhvillimin e mëtejshëm të bashkëpunimeve ndërmjet këtij tarikati dhe Komunitetit Mysliman të Shqipërisë.



Myftinia e Librazhdit viziton kreun e KMSH-së

Kryetari i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, H. Bujar Spahiu, priti në selinë e institucionit Myftiun e Librazhdit, z. Ardit Hoxhllaku dhe imamët e kësaj myftinie me rastin e zgjedhjes së tij në krye të KMSH-së.

Në fjalën e tij, Myftiu i Librazhdit, u ndal në disa çështje aktuale të myftinisë që ai drejton, duke theksuar aktivitetin e deritanishëm, nevojat e besimtarëve të Librazhdit dhe angazhimin e përditshëm të imamëve në shërbim të Islamit. Më tej ai uroi kreun e KMSH-së për zgjedhjen e tij në këtë detyrë.

Ndërsa Kryetari Spahiu theksoi bashkëpunimin dypalësh si një element mjaft të rëndësishëm në mbarëvajtjen dhe mirëfunksionimin e përgjegjësive në shërbim të besimtarëve myslimanë të Librazhdit dhe jo vetëm. Në fund ai i falënderoi përzemërsisht Myftiun dhe imamët e pranishëm për vizitën dhe urimet.





Kryetari i KMSH-së priti në një takim myftiun e Tropojës

Kryetari i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, H. Bujar Spahiu, priti në një takim myftiun e Tropojës, z. Eduart Demiraj.

Myftiu shprehu urimet më të mira për kreun e KMSH-së, për suksese të mëtejshme dhe vazhdimësi në kumtimin dhe përhapjen e mesazheve dhe vlerave të Islamit.

Kryetari i KMSH-së e falënderoi myftiun për kontributin e tij në shërbim të Islamit. Më tej ai tha se KMSH nën drejtimin e tij do të jetë në mbështetje të tyre, që vlerat dhe mesazhet e fesë sonë të përcillen tek besimtarët në mënyrën më të mirë.



aktivitete

prill

Ambasadori i Egjiptit në Tiranë viziton kryetarin e KMSH-së

Kryetari i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, H. Bujar Spahiu, priti në një takim në selinë e institucionit, Ambasadorin e Egjiptit në Tiranë, z. Mohamed Khalil. Bashkëbisedimi ndërmjet tyre u përqendrua mbi marrëdhëniet e deritanishme të të dy institucioneve. Më tej, Ambasadori z. Khalil, i shprehu Kryetarit Spahiu urimet e tij personale, urimet e Shejhut të Ez'herit, Prof. Dr. Ahmed Tajib dhe të Ministrit të Vakfeve të Egjiptit, Prof. Dr. Mohamed Mokhtar Xhum'a, me rastin e zgjedhjes së z. Spahiu në krye të Komunitetit Mysliman të Shqipërisë.

Nga ana e tij, Kryetari Spahiu, e falënderoi ambasadorin për vizitën dhe urimet e përcjella në emër të Shejhut të Ez'herit dhe Ministrit të Vakfeve të Egjiptit, dhe shprehu vullnetin e tij për ti forcuar më tej marrëdhëniet ndërmjet institucioneve në fusha të ndryshme me interes të përbashkët.



Kryetari i Tarikatit “Kadiri” viziton kreun e KMSH-së

Kryetari i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, H. Bujar Spahiu, priti në një takim Kryetarin e Tarikatit “Kadiri”, Shejh Bujar Harasani.

Pasi i shprehu urimet kreut të KMSH-së me rastin e zgjedhjes së tij në krye të institucionit, z. Harasani, u ndal në marrëdhënien e deritanishme të tarikatit që ai përfaqëson dhe Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, duke e vënë theksin mbi unitetin dhe bashkëpunimin dypalësh.

Kryetari Spahiu e falënderoi z. Harasani për vizitën dhe urimet dhe shprehu gatishmërinë e tij për zhvillimin e mëtejshëm të bashkëpunimeve ndërmjet këtij tarikati dhe Komunitetit Mysliman të Shqipërisë.





Myftiu i Kavajës uron kryetarin e KMSH-së

Kryetari i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, H. Bujar Spahiu, priti në një takim në selinë e institucionit, Myftiun e Kavajës, z. Besnik Leçini. Në fjalën e tij, z. Leçini, e uroi kryetarin Spahiu për zgjedhjen e tij në krye të institucionit dhe e siguroi atë për vazhdimësinë e kontributit në shërbim të besimtarëve myslimanë në myftininë e Kavajës. Ndërsa kryetari i KMSH-së e falënderoi atë për vizitën dhe urimet e përcjella dhe u ndal në diskutimin e tematikave të ndryshme në lidhje me zhvillimin e mëtejshëm të kësaj myftinie.





Myftiu, Naim ef. Tërnavë së bashku me përfaqësues të tjerë të BIK vizitojnë KMSH-në

Kryetari i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, H. Bujar Spahiu, priti në selinë e institucionit një delegacion me përfaqësues të lartë të Bashkësisë Islame të Kosovës, të kryesuar nga Myftiu, Naim ef. Tërnavë.

Bashkëbisedimi ndërmjet tyre u përqendrua në marrëdhënien dhe bashkëpunimet e deritanishme ndërmjet dy institucioneve.

Më tej, Myftiu Tërnavë, e uroi kryetarin Spahiu për zgjedhjen e tij në krye të Komunitetit Mysliman Shqiptar, dhe i shprehu atij gatishmërinë e institucionit që ai përfaqëson për ta vazhduar më tej frymën e mirë të bashkëpunimit në shërbim të fesë Islame.

Nga ana e tij, Kryetari i KMSH-së, z. Spahiu, pasi i falënderoi të pranishmit për vizitën dhe urimet, i siguroi ata se nën drejtimin e tij, Komuniteti Mysliman i Shqipërisë do të jetë gjithmonë pranë besimtarëve myslimanë shqiptarë që jetojnë përtej kufijve. Po ashtu ai nënvizoi se marrëdhëniet e mirë që i ka karakterizuar deri më sot të dy bashkësitë do të konkretizohet më tej në fusha të ndryshme me interes të përbashkët.











Nisin “Frytet e Besimit” në qytetin e Kavajës

Cikli i mbrëmjeve fetare “Frytet e Besimit” u zhvillua këtë herë në xhaminë e qendrës në qytetin e Kavajës, duke filluar kështu sezonin e ri të referimeve me tematika të ndryshme fetare me besimtarët myslimanë në mbarë vendin.

Programi u hap me leximin e disa ajeteve Kuranore menjëherë pas faljes së namazit të akshamit, ku të pranishëm ishin dhjetëra besimtarë të këtij qyteti. I ftuari i parë në këtë cikël takimesh me besimtarët ishte Nënkrjetari i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, z. Lauren Luli, i cili referoi mbi temën: “Në prag të muajit të begatë të Ramazanit”.

Gjatë fjalës së tij ai u ndal në shembullin e Profetit Muhamed a.s, si shembullin ku të gjithë ne duhet të bazohemi për ta pritur muajin e begatë të Ramazanit. Më tej, fjalën e mori Myftiu i Kavajës, z. Besnik Leçini, i cili pasi falënderoi të pranishmit për pjesëmarrjen, u ndal në raportin dhe lidhjen që duhet të ketë besimtari me Krijuesin e Gjithësisë, veçanërisht gjatë këtyre muajve.

Programi vazhdoi më tej me dua dhe pyetje-përgjigje nga besimtarët e pranishëm.



Drejtori i Përgjithshëm i Burgjeve viziton KMSH-në

Kryetari i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, H. Bujar Spahiu, priti në selinë e institucionit Drejtorin e Përgjithshëm të Burgjeve, z. Agim Ismaili.

Në fjalën e tij, z. Ismaili, vlerësoi kontributin e deritanishëm të KMSH-së në shoqëri dhe u ndal në bashkëpunimin ndërinstitucional që e karakterizon atë në disa fusha të ndryshme. Më tej ai e uroi Kryetarin Spahiu për zgjedhjen e tij në krye të institucionit.

Në fjalën e tij, Kryetar Spahiu, pasi e falënderoi për vizitën dhe urimet, e siguroi atë se nën drejtimin e tij Komunitetit Mysliman i Shqipërisë do të vazhdojë të kontribuojë edhe më tej në mbarëvajtjen dhe mirëfunksionimin e shoqërisë.





I ngarkuari me punë i Ambasadës së Kosovës viziton KMSH-në

Kryetari i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, H. Bujar Spahiu, priti në një takim në selinë e institucionit, të Ngarkuarin me Punë në Ambasadën e Kosovës në Tiranë, z. Sylë Ukshini. Gjatë takimit ata diskutuan mbi tema të ndryshme të karakterit fetar, social e kulturor. Më tej, z. Ukshini, vlerësoi kontributin e KMSH-së ndër vite dhe shprehu gatishmërinë e bashkëpunimit të mëtejshëm ndërmjet dy institucioneve. Ndërsa kryetari Spahiu, pasi e falënderoi z. Ukshini për vizitën dhe urimet, u ndal në planet afatgjata të institucionit në fushat e lartpërmendura si një strategji për të kontribuar më tej në zhvillimin e shoqërisë tonë të përbashkët.





Këshilli i Presidencës së Këshillit Ndërfetar të Shqipërisë zhvilloi mbledhjen e radhës dhe të parën për vitin 2019

Në mbledhjen e zhvilluar, merrnin pjesë krerët e pesë komuniteteve fetare në vend, bashkëdrejtues dhe të KNFSH-së, Kryetari i Këshillit Ndërfetar, Fortlurturia e tij Anastas Janullatos, njëkohësisht dhe kreu i Kishës Ortodokse Autoqefale të Shqipërisë, H. Bujar Spahiu, kryetar i Komuniteti Mysliman të Shqipërisë, Mons. George Frendo, kreu i Konferencës Ipeshkvnore Katolike të Shqipërisë, H. Dede Edmond Brahimaj, kreu i Kryegjyshitës Botërore Bektashiane, si dhe Pastor Ylli Doçi, kryetar i Vëllazërisë Ungjillore të Shqipërisë.

Takimi ndërfetar i mbajtur në Qendrën Sinodike të Kishës Ortodokse është hapur nga Fortlurturia e tij Anastas Janullatos, i cili këtë vit ka dhe presidencën e radhës të KNFSH-së, i cili ka falenderuar të gjithë të pranishmit për pjesëmarrjen në këtë mbledhje.

Gjithashtu kreu i KNFSH-së, si dhe të gjithë krerët e komuniteteve fetare kanë vlerësuar edhe kontributin e ish-kryetarit të KMSH-së H. Skender Bruçaj në Këshillin Ndërfetar të Shqipërisë dhe në dialogun ndërfetar gjatë drejtimit të tij të KMSH-së.

Më pas mbledhja ka vijuar sipas rendit të ditës, agjendë e cila është bërë e ditur nga Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit Ndërfetar Dr. Genti Kruja, ku është bërë një pasqyrë e punës së KNFSH-së në 6-mujorin e fundit (tetor 2018-prill 2019), siç ishte përfundimi i procedurave zyrtare për regjistrimin e ndryshimeve statutoe të KNFSH-së, regjistrimi në organet tatimore, pajisja me NIPT, hapja e llogarisë bankare në emër të Këshillit Ndërfetar, hapja e faqes web (knfsh.al) dhe në rrjetet sociale, etj..

Anëtarët e Këshillit të Presidencës gjatë kësaj mbledhjeje kanë diskutuar për disa problematika shqetësuese për të gjithë komunitetet fetare, siç janë çështja e pronave dhe moskthimi i tyre nga shteti shqiptar, problemi i objekteve të kultit dhe materialeve arkivore të sekuestruara nga regjimi komunist dhe moskalimi i tyre te pronarët e vërtetë, komunitet fetare në Shqipëri, etj.









Cikli i mbrëmjeve fetare “Frytet e Besimit” u zhvillua në Xhaminë e Medresesë, Tiranë

Programi filloi me leximin e disa ajeteve Kuranore menjëherë pas faljes së namazit të akshamit, ku ishin të pranishëm dhjetëra besimtarë myslimanë të zonës.

Në fjalën e tij hapëse, Drejtori i Kulturës dhe Arsimit pranë Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, z. Dorian Demetja, u ndal në rëndësinë e adhurimeve të shumta përgjatë muajit të ramazanit, duke e ilustruar fjalimin e tij me shembuj të shumtë nga jeta e Profetit (a.s).

Më tej, fjalën e mori i ftuari i dytë, z. Veton Tulla, Pedagog i Departamentit të Shkencave Islame pranë KU Bedër, i cili bëri një përmbledhje të kuptimit të 3 muajve të begatë në të cilët ndodhemi, rëndësinë që kanë ato në jetën e besimtarëve myslimanë dhe mënyrën se si ne duhet ti përjetojmë këto 3 muaj, veçanërisht muajin e Ramazanit.

Aktiviteti vazhdoi më tej me pyetje të ndryshme nga besimtarët të cilët prekën tematika të ndryshme të muajit që po afrohesh.



Kryetari i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, H. Bujar Spahiu, vizitoi Presidentin e Republikës, Sh.T.Z. Ilir Meta

Në fjalën e tij, Presidenti Meta, e përgëzoi kryetarin Spahiu me rastin e zgjedhjes së tij në krye të institucionit dhe vlerësoi rolin e shquar të Komunitetit Mysliman, që nga themelimi i shtetit shqiptar e deri në ditët e sotme.

Gjithashtu Presidenti Meta vuri në dukje domosdoshmërinë e intensifikimit të përpjekjeve për të bërë të mundur kthimin e pronave Bashkësive Fetare dhe kompensimin e tyre sa më parë nga shteti.

Ndërsa kryetari Spahiu, pasi e falënderoi Presidentin Meta për pritjen dhe urimet, u ndal në vendosmërinë e tij për të kontribuar më tej në zhvillimin fetar, ekonomik dhe social të vendit.

Bashkëbisedimi ndërmjet tyre vijoi më tej duke theksuar rëndësinë e madhe të bashkëpunimit mes institucioneve fetare në vend me ato shtetërore në të gjitha fushat.





Kryepeshkopi i Kishës Ortodokse Autoqefale të Shqipërisë, viziton KMSH-në

Kryetari i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, H. Bujar Spahiu, priti në një vizitë në selinë e institucionit, Kryepeshkopin e Kishës Ortodokse Autoqefale të Shqipërisë, z. Anastas Janullatos. Temë e bashkëbisedimit ndërmjet tyre ishte angazhimi i vazhdueshëm ndërmjet komuniteteve fetare të Shqipërisë që gjuhës konfliktuale dhe situatave armiqësore në të cilat bota jeton sot, ti përgjigjen me një model të vërtetë bashkëjetese. Më tej, Kryepeshkopi Janullatos e uroi kreun e KMSH-së me rastin e zgjedhjes së tij në krye të institucionit dhe i uroi atij punë të mbarë në përmbushjen e përgjegjësiave në shërbim të besimtarëve myslimanë të vendit tonë. Ndërsa kryetari Spahiu, pasi e falënderoi për urimet dhe vizitën, vlerësoi bashkëpunimin e deritanishëm të institucioneve fetare në vend në promovimin e vlerave kulturore, sociale dhe atdhedashëse në shoqërinë tonë.





aktivitete

maij

KMSH nis fushatën në ndihmë të 7300 familjeve në nevojë

Në prag të Muajit të Bekuar të Ramazanit, Komuniteti Mysliman i Shqipërisë në bashkëpunim me Qendrën Bamirëse dhe Humanitare “Mbreti Selman” dhe Ambasadën e Arabisë Saudite në Tiranë çelën fushatën e bamirësisë në ndihmë të 7300 familjeve me vështirësi ekonomike në mbarë vendin tonë.

Fushata nisi në ambientet e Medresesë së Tiranës, ku kryetari i KMSH-së, H. Bujar Spahiu dhe ambasadori i Arabisë Saudite në Tiranë, z. Abdelmomen Mohammed Sharaf dhe disa përfaqësues të shoqatës shpërndanë një pjesë të pakove për disa nga familjet në nevojë të kryeqytetit.

Në fjalën e tij kryetari i KMSH-së falënderoi Qendrën Bamirëse dhe Humanitare “Mbreti Selman” dhe Ambasadën e Arabisë Saudite në Tiranë për bashkëpunimin me KMSH-në në shpërndarjen e pakove ushqimore për familjet në nevojë.

Ndërsa ambasadori i Arabisë Saudite në Tiranë falënderoi KMSH-në për bashkëpunimin dhe tha se është i nderuar që merr pjesë në shpërndarjen e ndihmave për të gjithë vëllezërit shqiptar.

Fillimisht pakot me nga 80 kg ushqime secila (600 ton), do t’ju dorëzohen përfaqësuesve të KMSH-së në çdo qytet të vendit, më pas këta të fundit do t’jua shpërndajnë familjeve në nevojë. Ky projekt me vlerë mbi 500 000 euro do të shtrihet në gjithë qytetet e Shqipërisë.





NOT FOR SALE

المملكة العربية السعودية

MBRETERIA E ARABISE SAUDITE



مركز الملك سلمان للإغاثة والأعمال الإنسانية

QENDRA E MBRETTIT SELMAN PER NDIHMA DHE BAMIRESI

NOT FOR SALE

المملكة العربية السعودية

MBRETERIA E ARABISE SAUDITE



مركز الملك سلمان للإغاثة والأعمال الإنسانية

QENDRA E MBRETTIT SELMAN PER NDIHMA DHE BAMIRESI

NOT FOR SALE

المملكة العربية السعودية

MBRETERIA E ARABISE SAUDITE



مركز الملك سلمان للإغاثة والأعمال الإنسانية

QENDRA E MBRETTIT SELMAN PER NDIHMA DHE BAMIRESI

المملكة العربية السعودية

MBRETERIA E ARABISE SAUDITE



مركز الملك سلمان للإغاثة والأعمال الإنسانية

QENDRA E MBRETTIT SELMAN PER NDIHMA DHE BAMIRESI





“Frytet e Besimit” ndalen në Xhaminë e “Pazarit” në Krujë

Cikli i mbrëmjeve fetare “Frytet e Besimit” u zhvillua pas namazit të akshamit në Xhaminë e “Pazarit” në Krujë, ku kryetari i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, H. Bujar Spahiu, ligjëroi për të pranishmit mbi vlerën dhe dobinë që na sjell muaji i bekuar i Ramazanit.

Programi filloi me leximin e ajeteve Kur’anore nga nënkryetari i KMSH-së, z. Lauren Luli.

Myftiu i Krujës, z. Eriol Haxhiu pasi bëri një hyrje mbi rëndësinë e programeve dhe takimeve të përbashkëta fetare i kaloi fjalën kryetarit të KMSH-së.

Kryetari Spahiu në ligjëratën e tij u fokusua në vlerësimin që duhet t’i bëjë besimtari muajit të Bekuar të Ramazanit, mirësive dhe mëshirës së këtij muaji.

Në fund të programit myftiu i Krujës falënderoi kryetarin e KMSH-së për ligjërimin dhe tha se këto tubime sjellin dritë, ri-zgjojnë ndjenjën e besimit dhe rimëkëmbin vlerat islame.





Myftinia e Elbasanit organizon programin festiv “Ramazani, muaji i vlerave dhe i harmonisë”

Myftinia e Elbasanit dhe sektori i gruas pranë kësaj myftinie, organizuan në ambientet e kompleksit Rozafa, programin festiv me titull: “Muaji i Ramazanit, muaji i vlerave dhe i harmonisë”. Në aktivitet morën pjesë Kryetari i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, H. Bujar Spahiu, Drejtori i Medias, z. Agron Hoxha, Myftiu i Elbasanit, z. Agim Duka, Anëtar i Këshillit të Përgjithshëm të KMSH-së, Dr. Arben Ramkaj, Imami i Xhamisë Dine Hoxha, z. Ahmed Kalaja, Poeti i njohur Islam, z. Behaaddin Gashi, Myftiu i Librazhdit, z. Ardit Hoxhllaku si dhe përfaqësues të tjerë fetarë dhe figura të shquara të qytetit të Elbasanit. Programi u hap me leximin e disa ajeteve Kuranore rreth agjërit, për të vijuar më tej me fjalën përshëndetëse të Myftiut të Elbasanit, z. Duka.

Ndërsa Kryetari i KMSH-së, H. Bujar Spahiu, në fjalën e tij falënderoi Myftininë e Elbasanit për organizimin e këtij programi dhe u ndal në dobiet shpirtërore dhe fizike të këtij muaji. Programi vazhdoi më tej me ilahi dhe poezi të zgjedhura kushtuar këtij muaji të bekuar. Më tej ishte radha e Imamit Ahmed Kalaja për të referuar mbi “Vlerat e Muajit të Ramazanit”.









Kryetari i KMSH-së merr pjesë në konferencën ndërkombëtare në Arabinë Saudite

Kryetari i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, H. Bujar Spahiu mori pjesë në konferencën ndërkombëtare me temë: “Vlerat e mesatarizmit në tekstet Kuranore dhe Traditës Profetike”. Kjo konferencë u zhvillua ë Arabinë Sauditë, në qytetin e Mekës nga “Lidhja e Botës Islame – Rabita” dhe nën kujdesin e mbretit të Arabisë Saudite, Selman bin Abdulaziz Al Saud.

Në këtë konferencë morën pjesë rreth 800 të ftuar nga e gjithë bota, kryesisht lider fetarë, por pjesë e konferencës ishin edhe shumë studiues dhe personalitete të fushave të ndryshme.

Ndër të tjera kryetari i KMSH-së ka zhvilluar takime me myftiun e Egjiptit, Sheuki Ibrahim Alam dhe Ministrin Egjiptian të Vakëfeve, Muhamed Mukhtar Xhuma.

Gjatë takimit u diskutua mbi intensifikimin e mëtejshëm të marrëdhënieve me Ministrinë e Vakëfeve, Universitetin e Ez’herit dhe në fusha të ndryshme.



“Feja në shoqëri: Modeli Shqiptar”

Instituti i Bashkëpunimit për Integrimin dhe Zhvillimin në bashkëpunim me komunitetet fetare të vendit tonë, zhvilluan në ambientet e “Muzeut Historik Kombëtar” aktivitetin me titull: “Feja në shoqëri: Modeli Shqiptar”.

Ky eveniment, i cili vijoi me aktivitete të tjera ndërmjet komuniteteve fetare në dy ditët e ardhshme, synon të promovojë dhe kultivojë një vlerë të shquar dhe të dallueshme të shoqërisë shqiptare, bashkëjetesën në diversitetin e bashkësive fetare shqiptare në harmoni, paqe dhe integritet.

Në këtë takim ishin të pranishëm përfaqësuesit më të lartë të komuniteteve fetare të vendit, si Kryetari i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, H. Bujar Spahiu, Kryepeshkopi i Kishës Ortodokse Autoqefale të Shqipërisë, Fortlumenturia e tij Anastas Janullatos, Kryetari i Konferencës Ipeshkvore të Shqipërisë, Arqipeshkvi i Tiranë - Durrës, Mons. George Frendo, përfaqësues i Kryegjyshitës Bektashiane, Kryetari i Vëllazërisë Ungjillore të Shqipërisë, Pastor Ylli Doçi, sekretari i përgjithshëm i Këshillit Ndërfetar Dr. Genti Kruja, Nunci Apostolik në Tiranë Charles John Brown,

Drejtor i Muzeut Historik Kombëtar Dr. Dorian Koçi, dekani i Fakultetit të Shkencave Humane nga Universiteti Bedër Prof. Asoc. Rahim Ombashi, nënkryetari i Bashkisë Tiranë, si dhe përfaqësues të lartë të institucioneve të ndryshme.

Në fjalën e tij Kryetari i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, z. Spahiu, u ndal në harmoninë dhe bashkëjetesën fetare të vendit tonë si një vlerë e veçantë në traditën e vendit tonë prej shekujsh, duke theksuar se në të gjithë historinë e saj Shqipëria ka ditur ta ruajë këtë aset të çmuar, duke qëndruar edhe sot e kësaj dite një model unikal në të gjithë botën.

Aktiviteti vazhdoi më tej me referimin e krerëve të lartpërmendur të cilët prekën dhe njëherë asetin më të çmuar të vendit tonë, tolerancën dhe harmoninë ndërfetare si një model për t’ia përcjell të gatshëm botës.







Ramazan 2019, KMSH shtron iftarin e parë

Komuniteti Mysliman i Shqipërisë shtroi iftarin e parë të Ramazanit, ku morën pjesë presidenti i Republikës së Shqipërisë, SH.T.Z. Ilir Meta, Prefektja e Tiranës, znj. Suzana Jahollari, kryetarja e Komitetit Shtetëror për Kultet, znj. Loreta Aliko, përfaqësues të komuniteteve fetare në vend, ambasadorë të vendeve të ndryshme të akredituar në Tiranë, njerëz në nevojë, individë me aftësi të kufizuara, besimtarë, imamë, drejtues institucionesh si dhe shumë figura të jetës fetare, politike e shoqërore.

Kryetari i Komunitetit Mysliman, H. Bujar Spahiu, i uroi të pranishmëve mirëseardhjen duke u lutur që Komuniteti Mysliman e ka kthyer në traditë shtrimin e iftarit të parë të Ramazanit. Nëpërmjet kësaj tryeze, institucioni i myslimanëve shqiptarë bashkon figura të rëndësishme të jetës publike, të cilët vijnë për të nderuar e respektuar sakrificën e myslimanëve në muajin më të rëndësishëm të kalendarit islam.















Dobitë shpirtërore dhe ato fizike të muajit të Ramazanit

“Dobitë shpirtërore dhe ato fizike të muajit të Ramazanit”, ishte kjo tema e hutbes së radhës që Kryetari i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, H. Bujar Spahiu, mbajti në xhaminë e re të Paskuqanit. Duke e ilustruar fjalimin e tij me shembuj të shumtë nga jeta e Profetit Muhamed a.s, Kryetari Spahiu, veçoi një sërë argumentesh që e bëjnë Ramazanin muajin e ftesës hyjnore, muajin e mëshirës, faljes, solidaritetit dhe shpërblimeve të panumërta të Allahut xh.xh.

Në fund ai u bëri thirrje dhjetëra besimtarëve të pranishëm për të falur namazin e xhumasë ti shtojnë adhurimet dhe veprat e pëlqyera te Zoti i Gjithësisë veçanërisht gjatë këtij muaji, pasi edhe shpërblimet në këtë muaj llogariten shumëfish më të mëdha sesa gjatë muajve të tjerë të vitit.



Zhvillohet konferenca me temë: “Të mbrojmë familjen si tempull të shenjtë”

Në ditën ndërkombëtare të familjes, përfaqësues të komuniteteve fetare të vendit zhvilluan në ambientet e “Tirana International Hotel” konferencën e përbashkët me temë: “Të mbrojmë familjen si tempull të shenjtë”.

Në këtë aktivitet, Komuniteti Mysliman i Shqipërisë u përfaqësua nga Përgjegjësja e Zyrës së Gruas, znj. Fatma Karaj.

Pasi përshëndeti të pranishmit, znj. Karaj u ndal në rëndësinë e organizimit të aktiviteteve të tilla në promovimin e vlerave të familjes në shoqërinë tonë. Sipas saj, të gjithë ne duhet të kontribuojmë vazhdimisht, duke filluar që nga rrethet e ngushta shoqërore e për të vijuar me tej me aktivitete dhe konferenca të rangut kombëtar, për ti dhënë brezave të rinj shembullin e duhur të familjes.

Aktiviteti vazhdoi më tej me referimin e përfaqësuesve të tjerë të komuniteteve fetare, të cilët në fjalët e tyre parashtuan rëndësinë e kontributit të të gjithëve ne në forcimin dhe promovimin e mëtejshëm të familjes shqiptare.



Bashkia Tiranë shtron iftar për Komunitetin Mysliman të Shqipërisë

Në kuadër të muajit të bekuar të Ramazanit, Kryetari i Bashkisë Tiranë, z. Erion Veliaj, shtroi një darkë iftari për Komunitetin Mysliman të Shqipërisë. Përpos stafit të institucionit, në iftar ishin të pranishëm gjithashtu edhe përfaqësues të institucioneve publike e private, personalitete dhe myftinj të rretheve të ndryshme të vendit. Në fjalën e tij të rastit, Kryetari i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, H. Bujar Spahiu, vlerësoi nismën e Bashkisë së Tiranës, për të shtruar iftare për shtresat në nevojë të qytetit përgjatë gjithë këtij muaji.









Ramazani mes nesh


Komuniteti Mysliman i Shqipërisë në bashkëpunim me Departamentin e Shkencave Islame në Kolegjin Universitar “Bedër”, organizuan programin artistik me titull: “Ramazani mes nesh”.

Në fjalën e tij, kryetari i KMSH-së, H. Bujar Spahiu, ndau me të pranishmit vlerën e këtij muaji të bekuar si dhe rëndësinë që ky adhurim ka për sfidat shpirtërore, individuale dhe shoqërore të kohës tonë. Mjeku i ftuar Arsel Dizdari foli mbi aspektet shkencore, vlerën e ramazanit dhe ndikimin që ai ka tek agjëruesi duke e lidhur atë edhe me studime në fushën e mjekësisë.

Pjesë e këtij programi ishin edhe poezitë dhe ilahitë e shumta të interpretuara nga vetë studentët e këtij departamenti.







Nënshkruhet memorandum mirëkuptimi mes Këshillit Ndërfetar dhe CVE- së

Këshilli Ndërfetar i Shqipërisë, i përfaqësuar nga pesë krerët e komuniteteve fetare në vendin tonë, nënshkroi me dt. 17 maj 2019 një memorandum mirëkuptimi me Qendrën e Koordinimit Kundër Ekstremizmit të Dhunshëm (CVE). Në këtë ceremoni të zhvilluar në zyrat e CVE-së merrnin pjesë përfaqësuesit më të lartë të komuniteteve fetare, respektivisht, Kryetari i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, H. Bujar Spahiu, Kryepeshkopi i Tiranës, Durrësit dhe gjithë Shqipërisë Fortlumturia e Tij Anastasi (njëkohësisht kryetar i KNFSH-së), Arqipeshkvi i Tiranës dhe Durrësit, Mons. George Frendo, Kryegjyshi Botëror i Bektashinjve, H. Dede Edmond Brahimaj dhe Kreu i Vëllazërisë Ungjillore të Shqipërisë Pastor Ylli Doçi. Memorandumi i bashkëpunimit midis Këshillit Ndërfetar të Shqipërisë (KNFSH) dhe Qendrës së Koordinimit Kundër Ekstremizmit të Dhunshëm (CVE), u firmos nga pesë liderët e lartpërmendur, si dhe nga z. Agron Sojati, drejtor i CVE-së. Memorandumi i bashkëpunimit vë theksin në disa pika, si:

- 1- Forcimin dhe ruajtjen e marrëdhënieve dhe harmonisë ndërfetare, rritjen e bashkëpunimit në interes të paqes, sigurisë dhe bashkëjetesës.
- 2- Rritjen e frymës së bashkëpunimit midis Komunitetet Fetare në Shqipëri dhe Qendrës Kundër Ekstremizmit të Dhunshëm.
- 3- Ngritja dhe institucionalizimi i bashkëpunimit mes Qendrës CVE e Komuniteteve Fetare në Shqipëri, në raporte bilaterale me çdo komunitet dhe në kuadrin e Këshillit Ndërfetar të Shqipërisë.
- 4- Monitorimi i teksteve shkollore dhe literaturës që hy në ambientet e vuajtjes së dënimit, për të shmangur informacionet që bien ndesh me të vërtetat fetare, që dëmtojnë klimën e besimit e të mirëkuptimit mes besimtarëve, që nxisin dhunën dhe urrejtjen, kundërshtimin e ligjeve, apo rregullave të bashkëjetesës në komunitet.
- 5- Institucionalizimi i bashkëpunimit mes qeverisjes vendore dhe strukturave vendore të komuniteteve fetare nëpërmjet Qendrës CVE, e cila do të ushtrojë gjithë angazhimin dhe përgjegjësinë e saj për ta bërë të mundur këtë, etj..



Kryetari i KMSH-së viziton Myftininë e Korçës

Me rastin e muajit të bekuar të ramazanit, kryetari i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, H. Bujar Spahiu dhe nënkryetari i KMSH-së, z. Lauren Luli vizituan Myftininë e Korçës.

Fillimisht kryetari i KMSH-së ishte për ligjëratë para namazit të akshamit në Xhaminë e Medresesë së Korçës. Gjatë fjalës së tij, ai foli mbi mirësitë dhe vlerat e muajit të Ramazanit.

Ndërkohë myftiu i Korçës, z. Ledian Cikalleshi, falënderoi kryetarin për vizitën dhe shtoi se ky muaj është muaj i vëllazërimit dhe begatisë.

Pas faljes së namazit, kreu i KMSH-së, nënkryetari, myftiu i Korçës, imamë të këtij rrethi dhe besimtarë të shumtë morën pjesë në iftarin që kjo myftini shtroi për agjëruesit në ambientet e xhamisë.

Vizita e kryetarit vijoi me takimin e imamëve të zonës së Korçës.

Në fund u zhvillua një vizitë edhe në ambientet e myftinisë, ku myftiu i Korçës, z. Ledian Cikalleshi e njohu kryetarin më nga afër mbi ecurinë dhe mbarëvajtjen e punëve në këtë myftini.









Myftinia e Shkodrës shtron iftar me personalitete dhe intelektualë të qytetit

Kryetari i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, H. Bujar Spahiu, mori pjesë në iftarin e organizuar nga Myftinia e Shkodrës, iftar ky i cili mbledhi sëbashku dhjetëra personalitete dhe përfaqësues fetarë të këtij qyteti, përfaqësues të shoqatave bamirëse, drejtues të myftinive Prizren dhe Ulqin, si dhe pedagogë dhe intelektualë të qytetit të Shkodrës.

Në fjalën e tij hapëse, Myftiu i Shkodrës, z. Muhamed Sytari, pasi falënderoi të pranishmit për pjesëmarrjen, u ndal në ndryshimin e atmosferës që sjell ky muaj jo vetëm në qytetin e Shkodrës por në të gjithë Shqipërinë.

Ndërsa Kryetari Spahiu, në fjalën e tij vlerësoi unitetin e tryezave të tilla si një shembull paqeje, vëllazërie e solidariteti të cilin duhet ta forcojmë dhe tua përcjellim brezave të ardhshëm për një vend sa më afër besimit në Zot.

Pas përfundimit të darkës së iftarit, Kryetari i KMSH-së dhe Myftiu i Shkodrës referuan mbi vlerat dhe dobësitë fizike e shpirtërore të muajit të Ramazanit në Xhaminë e Parrucës.





Studentë nga 8 universitete vizitojnë KMSH-në

Kryetari i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, H. Bujar Spahiu, priti në një vizitë në selinë e institucionit, studentë nga 8 universitete të ndryshme pjesëmarrës në Institutin për Lirinë Fetare dhe Demokracinë.

Gjatë këtij takimi, Kryetari Spahiu, i njohu ata me strukturën e organizimit të KMSH-së, historikun e institucionit, kontributin e tij në promovimin e vlerave të tolerancës fetare në vend, misionin dhe rolin e institucionit në shoqërinë tonë.

Në fund të takimit studentët vizituan nga afër ambientet e Radio Spektrum ku u njohën me studiot dhe programacionin e saj. Më tej ata zhvilluan një vizitë edhe në kompleksin e xhamisë së namazgjasë.



Kryetari i Kuvendit, z. Gramoz Ruçi, shtron iftar për Muajin e Ramazanit

Në kuadër të muajit të bekuar të ramazanit, Kryetari i Kuvendit të Shqipërisë, z. Gramoz Ruçi, shtroi një darkë iftari për Komunitetin Mysliman të Shqipërisë. Përpos stafit të institucionit, në iftar ishin të pranishëm gjithashtu edhe përfaqësues të komuniteteve të tjera fetare të vendit, deputetë, gazetarë, drejtues institucionesh publike e private, personalitete dhe myftinj të rretheve të ndryshme të vendit.

Në fjalën e tij përshëndetëse Kryetari i Kuvendit u ndal në vlerat humane që kultivon për shoqërinë tonë të përbashkët muaji i Ramazanit.









Ambasada e SHBA-ve shtron iftar me rastin e Ramazanit

Ambasada e Shteteve të Bashkuara të Amerikës në Tiranë shtoi një darkë iftari në respekt të muajit të bekuar të Ramazanit.

Të pranishëm në iftarin e shtruar nën kujdesin e të Ngarkuarës me Punë të SHBA-ve, znj. Leyla Moses-Ones, ishte kryetari i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, H. Bujar Spahiu, kryegjyshi i Bektashinjve, H. Dede Edmond Brahimaj, kryetarja e Komitetit Shtetëror për Kultet, znj Loreta Aliko, punonjës të KMSH-së, përfaqësues të Universitetit “Bedër” dhe Medresesë së Tiranës, si dhe punonjës të ambasadës.

Gjatë fjalës së saj, Znj, Leyla Moses-Ones falënderoi të ftuarit për pjesëmarrjen dhe i'u uroi atyre agjërim të pranuar.

Ndërsa Kryetari i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, H. Bujar Spahiu falënderoi Ambasadën e SHBA-ve për shkrimin e iftarit dhe bëri lutjen përpara hapjes së tij.









Zyra e Gruas, iftar me personalitete të vendit

Zyra e Gruas në Komunitetin Mysliman të Shqipërisë, shtroi një iftar ku ishin të pranishëm prefektja e Tiranës, znj. Suzana Jahollari, kryetarja e Komitetit Shtetëror për Kultet, znj. Loreta Aliko, nënkryetrja e Këshillit të Qarkut Tiranë, znj. Bora Panajoti, aktorja e mirënjohur, znj. Tinka Kurti, znj. Ajola Xoxa, përfaqësuese të botës së mendimit, biznesit, artit, politikës, medias, drejtuese të shoqatave të ndryshme, si dhe përfaqësuese të shoqërisë civile dhe botës akademike.

Të pranishmet i përshëndeti përgjegjësjë e Zyrës së Gruas në KMSH, znj. Fatma Karaj, e cila theksoi se Ramazani është muaji i mëshirës, përkushtimit dhe dashurisë për Zotin. Ajo gjithashtu falënderoi pjesëmarrëset në iftar për bashkëpunimin që kanë pasur me Zyrën e Gruas, si dhe për kontributin që ata kanë ofruar, për zhvillimin e projekteve dhe aktiviteteve të ndryshme.

Gjithashtu të pranishmet u përshëndetën edhe nga prefektja e Tiranës, znj. Suzana Jahollari dhe nga kryetarja e Komitetit Shtetëror për Kultet, znj. Loreta Aliko. Ato falënderuan Zyrën e Gruas për iftarin dhe kontributin e vazhdueshëm që kjo zyrë jep për shoqërinë dhe gruan në veçanti.









Presidenti Meta shtron iftar me rastin e muajit të Ramazanit

Presidenti i Republikës, Sh. T. Z. Ilir Meta, shtroi një darkë Iftari me rastin e muajit të bekuar të Ramazanit.

Të pranishëm në iftar ishin kryetari i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, Haxhi Bujar Spahiu, udhëheqës fetarë dhe shpirtërore të bashkësive fetare shqiptare, ambasadorë dhe përfaqësues diplomatikë, teologë, përfaqësues nga komunitetet në nevojë, moshë e tretë, paraplegjikë dhe personalitete të ndryshme.

Presidenti Meta pasi i'u uroi mirëseardhjen të pranishmëve tha se ndihet i lumtur që ndajmë së bashku respektimin dhe nderimin për Muajin e madhërueshëm të Ramazanit në një lagje të thjeshtë të kryeqytetit tonë.





de

aktivitete

ershor



Myftinia e Lushnjës shtron iftar për besimtarët e qytetit

Në kuadër të muajit të bekuar të Ramazanit, Myftinia e Lushnjës në bashkëpunim me Shoqatën “Mirësia” shtroi iftar për besimtarët e qytetit.

Në këtë iftar ishin të pranishëm myftiu i Lushnjës, z. Gramoz Bliku, nënkryetari i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, z. Lauren Luli, drejtori i Shoqatës “Mirënjohja”, z. Korab Kaja, nënkryetari i Bashkisë së Lushnjës, z. Gentian Nushi, nënprefektja e qytetit, znj. Lindita Buxheli, personalitete të qytetit, imamë dhe besimtarë.

Në fjalën e tij përshëndetëse myftiu i Lushnjës, z. Bliku falënderoi shoqatën për kontributin e saj në shtrimin e iftarit dhe u uroi të pranishmëve agjërim të pranuar.

Nënkryetari i KMSH-së, z. Lauren Luli, falënderoi organizatorët e iftarit dhe tha se Ramazani është muaji i mirësive të pafundme, mëshirës, edukimit shpirtëror dhe unitetit.



Myftinia Vlorë shtron iftar për besimtarët e qytetit

Në kuadër të muajit të bekuar të Ramazanit, Myftinia e Vlorës, shtroi një darkë iftari për besimtarë dhe personalitete të ndryshme të këtij qyteti.

I pranishëm në këtë tryezë iftari ishte kryetari i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, H. Bujar Spahiu, Myftiu i Vlorës, z. Bilal Bodlli, Kryetari i Bashkisë, z. Dritan Leli, drejtues institucionesh, përfaqësues të komuniteteve të tjera fetare, personalitete dhe një numër i konsiderueshëm besimtarësh.

Në fjalën e tij hapëse, Myftiu z. Bodlli, shprehu falënderimet e tij për pjesëmarrjen e të pranishmëve dhe u ndal në atmosferën që solli ky muaj i bekuar në qytetin e Vlorës.

Më tej, Kryetari i KMSH-së, z. Spahiu, u ndal në vlerat që sjell ky muaj i begatë në jetën e të gjithë besimtarëve. Sipas tij Ramazani është simbol i dashurisë, respektit, sakrificës, durimit, vëllazërisë, bashkimit e shumë virtyteve të tjera.



Kryeministri Rama shtron iftar në Natën e Kadrit

Kryeministri i Shqipërisë, z. Edi Rama, ka shtruar në ambientet e Pallatit të Brigadave një iftar në Natën e Kadrit.

Të pranishëm në këtë iftar ishin kryetari i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, H. Bujar Spahiu, përfaqësues të KMSH-së dhe komuniteteve të tjera fetare në vendin tonë, deputetë të Kuvendit të Shqipërisë, përfaqësues të trupit diplomatik, përfaqësues të shoqatave islame, personalitete nga fusha të ndryshme, artistë e gazetarë.

Kryeministri ju uroi mirëseardhjen të ftuarve dhe shtoi se përjetimin e kësaj Nate të Mirë të Kadrit e bën më të ndjerë kumbimi i hijshëm i zërit të ezanit, i cili paqësisht, qetësisht, qartësisht thërret prej shembullit të përlësisë personale forcën e lutjes së përbashkët.

Ndërsa Kryetari i KMSH-së, H. Bujar spahiu falënderoi Kryeministrin për shtrimin e Iftarit dhe theksoi se muaji i Ramazanit është muaji i mëshirës, mirësisë, solidaritetit dhe dashurisë.

Ramazani është një shtysë themelore i cili përmirëson sjelljet e njeriut në botën e tyre shpirtërore, për të qenë njerëz të mirë me të tjerët dhe për të ndërtuar raporte më të mira me Krijuesin tonë.





Besimtarët myslimanë festojnë Fitër Bajramin

Mijëra besimtarë myslimanë falën namazin e Fitër Bajramit në "Sheshin Skënderbej" në Tiranë dhe mijëra të tjerë në sheshet kryesore të çdo qyteti të vendit.

Ceremonia filloi me fjalën përshëndetëse të Kryetarit të Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, H. Bujar Spahiu, i cili përcolli për të pranishmit urimet dhe përshëndetjet e kësaj dite gëzimi për të gjithë besimtarët myslimanë shqiptarë.

Në ligjëratën e rastit, Nënkryetari i Komunitetit Mysliman, z. Lauren Luli, pasi uroi të pranishmit për Fitër Bajramin u fokusua tek kujdesi dhe vëmendja ndaj familjes dhe rinisë. Më tej u bë falja e namazit të bajramit nga Kryetari i Komunitetit, z. Spahiu, për të vazhduar më pas me hytben e Fitër Bajramit e cila u mbajt po nga kryetari i KMSH-së.

Gjatë hytbes, Kryetari Spahiu, u lut për më shumë paqe, kënaqësi, gëzim dhe harmoni mes njerëzve të shoqërisë sonë.

Ndërsa moderatori i programit, Drejtori i Kulturës në KMSH, z. Dorian Demetja, u shpreh se Bajrami është dita ku kujtojmë njëri-tjetrin, është dita e ripërtëritjes së vëllazërisë, miqësisë dhe dashurisë për njeriun dhe njerëzoren.

Më pas besimtarët e pranishëm në shesh u shpërndanë për të festuar me familjet dhe të afërmit e tyre.

Gëzuar Fitorë Bajramin!



Komuniteti Mysliman
i Shqipërisë















Besimtarët myslimanë festojnë Fitër Bajramin

Menjëherë pas përfundimit të programit të Fitër Bajramit në “Sheshin Skënderbej”, Komuniteti Mysliman i Shqipërisë hapi dyert për të pritur vizita me rastin e kësaj feste.

Për të përcjellë mesazhet e urimit në Komunitetin Mysliman ishin ministrja e Kulturës, znj. Elva Margariti, ministrja e Financave dhe Ekonomisë, znj. Anila Denaj, kryebashkiaku i Tiranës, z. Erion Veliaj, kryetarja e Komitetit Shtetëror për Kultet, znj. Loreta Aliko, drejtues të institucioneve shtetërore, lokale, përfaqësues të subjekteve politike, trupit diplomatik, personalitete të jetës publike, të fushës së artit, medias, biznesit, etj.

Pjesë e kësaj dite të begatë e festive u bënë edhe drejtues të komuniteteve fetare, si: Kreu i Kishës Ortodokse, Anastas Janullatos, Kreu i Kishës Katolike, George Frendo, dhe Kryegjyshi Botëror i Bektashinjve, Haxhi Dede Edmond Brahimaj si dhe përfaqësues të tarikateve, Kryetari i Tarikatit Rufai, Shejh Qemaludin Reka dhe Kryetari i Tarikatit Kadiri, Shejh Bujar Harasani.

Në mesazhet e tyre drejtuar Kryetarit të Komitetit Mysliman të Shqipërisë, H. Bujar Spahiu, ata shprehën urimet dhe përshëndetjet e tyre të sinqerta për sakrificën e besimtarëve myslimanë gjatë muajit të bekuar të Ramazanit që lamë pas si dhe uruan besimtarët për më shumë mirësi në familje dhe shoqërinë tonë të përbashkët.


Komuniteti Mysliman i Shqipërisë falënderon të gjithë ata që morën pjesë në këto vizita si dhe të gjithë shqiptarët që kanë dërguar mesazhe urimi me rastin e kësaj feste.











Zhvillohet konferenca Rajonale me temë: “Roli i Fesë në Ballkanin Perëndimor”

Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim, në bashkëpunim me Ambasadën e Mbretërisë së Holandës dhe Presidentin e Republikës së Shqipërisë, Shtz. Ilir Meta, organizojnë Konferencën Rajonale me temë: “Roli i Fesë në Ballkanin Perëndimor”.

Kjo konferencë, e zhvilluar në ambientet e “Tirana International Hotel” mbledhi sëbashku përfaqësues të bashkësive të ndryshme fetare të Rajonit, si: Kryetari i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, H. Bujar Spahiu, Fortlumturia e tij Kryepeshkopi i Kishës Autoqefale Ortodokse Shqiptare, Anastas Janullatos, Arqipeshkvi Metropolit Imzot George Frendo i Kishës Katolike Shqiptare, Kryegjyshi Botëror i Bektashinjve Haxhi Baba Edmond Brahimaj, ambasadorë të trupit diplomatik të akredituar në Tiranë, përfaqësues të komuniteteve fetare të Kosovës, Maqedonisë së Veriut, Malit të Zi, studiues, akademikë dhe personalitete të ndryshëm, të cilët në referimet e tyre vunë theksin mbi fenë dhe ndikimin e saj në shoqëritë moderne.

Në fjalën e tij përshëndetëse, Presidenti Meta, tha se harmonia fetare është ndër vlerat më të vjera të Shqipërisë, e trashëguar nga kombi ynë ndër shekuj, e mbartur dhe forcuar nga qytetarët tanë dhe që u takon brezave të ardhshëm ta forcojnë dhe ta ruajnë atë si sytë e ballit. Si përfaqësuesi më i lartë i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, Kryetari, H. Bujar Spahiu, në fjalën e tij u shpreh se feja dhe prijësit fetarë gjithmonë kanë luajtur një rol të rëndësishëm në shoqëri. Myslimanët shqiptarë bashkë më prijësit e feve të tjera kanë qenë faktor kyç në formësimin e identitetit kombëtar.

Më tej ishte radha e përfaqësuesve të tjerë fetare dhe Presidentit të Shqipërisë, Shtz. Ilir Meta të përshëndetnin punimet e konferencës në seancën hapëse të saj, për t’ia lënë vendin referimeve të shumta të studiuesve të cilën sollën në fokus problematikat aktuale dhe zgjidhjet më të përshtatshme për çdo rast të shoqërive të Ballkanit Perëndimor.







“Kryet Nalt”, shfaqet dokumentari për klerikun Hafiz Ali Kraja

Dokumentari për klerikun e shquar shkodran Hafiz Ali Kraja, “Kryet nalt”, i realizuar nga Fondacioni kujto.al – Arkiva Online e Krimeve dhe Viktimave të Komunizmit në Shqipëri dhe Luljeta Progni është shfaqur për herë të parë premierë mbremjen e djeshme në Kinema Millennium në Shkodër. Dokumentari kushtuar klerikut të shquar Hafiz Ali Kraja tregon kalvarin e gjatë të persekutimeve që nga internimi prej fashistëve italianë, përndjekja ndaj tij dhe familjes prej komunistëve dhe vuajtjet për 18 vjet në kampet e punës e burgun e Burrelit.

Në këtë aktivitet ishin të pranishëm kryetari i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, H. Bujar Spahiu, myftiu i Shkodrës, z. Muhamed Sytari, kryetarja e Bashkisë së Shkodrës, znj. Voltana Ademi, themeluesi i Fondacioni Kujto, z. Agron Shehaj, personalitete, familjarë dhe të afërm të Hafiz Ali Krajës.

Kryetari i KMSH-së, H. Bujar Spahiu në fjalën e tij u shpreh se ky dokumentar i dedikohet një personaliteti që nuk i përket thjesht një komuniteti apo një qyteti. Dijetari, hoxha, mësuesi, aktivisti politik e atdhetari i madh Hafiz Ali kraja, me jetën dhe veprën e tij bën krenar gjithë Shqipërinë dhe shqiptarët. Kryetarja e Bashkisë së Shkodrës, Voltana Ademi tha se Hafuz Ali Kraja është pjesë e trashëgimisë së madhe të Shkodrës dhe ende sot mes banorëve të saj kujtohet kleriku i ditur.





Kryetari i KMSH-së pret në një takim Ambasadorin e Zvicrës

Kryetari i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, H. Bujar Spahiu, priti në një takim Ambasadorin e Zvicrës në Tiranë, z. Adrian Maître. Kreu i KMSH-së, z. Spahiu, pasi e njohu, z. Maître, me institucionin dhe rolin që ai ka në shoqërinë shqiptare i shprehu angazhimin për të bashkëpunuar me të gjithë organizmat vendase dhe të huaja të cilat i shërbejnë mbarëvajtjes së harmonisë dhe tolerancës ndërfetare si edhe ndikojnë pozitivisht në kohezionin social të Shqipërisë dhe rajonit. Ambasadori vlerësoi qëndrimet e KMSH-së ndër vite si edhe rolin e saj aktiv në promovimin e vlerave të besimit, gatishmërinë për të kontribuar në forcimin e marrëdhënieve ndërinstitucionale. Ambasadori z. Maître, çmoi punën dhe angazhimin e treguar nga KMSH në raport edhe me bashkësitë e tjera fetare në rajon.





Inaugurohet fillimi i punimeve të Xhamisë së re në Kiras, Shkodër

Kryetari i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, H. Bujar Spahiu, sëbashku me Drejtorin e Vakf- Investimeve dhe Financave në KMSH, z. Edison Hoti, Myftiun e Shkodrës, z. Muhamed Sytari, Drejtorin e Shoqatës “Mirënjohja” z. Samet Shehu, Kryetaren e Bashkisë Shkodër, znj. Voltana Ademi, donatorët si dhe dhjetëra besimtarë të këtij qyteti, inauguruan fillimin e punimeve të xhamisë së re të lagjes “Kiras” në Shkodër.

Në fjalën e tij përshëndetëse, Kryetari i KMSH-së, z. Spahiu, u ndal në rëndësinë që luajnë xhamitë në ruajtjen dhe forcimin e mëtejshëm të besimit në zemrat e besimtarëve. Sipas tij xhamitë janë një dyer drejt adhurimit të Zotit, si dhe një vatër e edukimit me vlerat e larta të Islamit.

Më tej ishte radha e Myftiut të Shkodrës, z. Sytari, të përshëndeste të pranishmit. Pasi falënderoi kontribuesit për ndërtimin e kësaj xhamie ai i'u bëri thirrje besimtarëve të zonës ta frekuentojnë sa më shpesh atë, pasi sipas tij, minaret e xhamisë janë jo vetëm një thirrje e vazhdueshme në rrugën e Islamit por njëkohësisht thirrje ndaj vlerave të larta morale e shoqërore.

Pas përfundimit të fjalëve përshëndetëse, të pranishmit inauguruan fillimin e punimeve të xhamisë duke hedhur simbolikisht gurin e parë në themelet e xhamisë.



Kryetari i KMSH-së viziton Medresenë e Korçës

Kryetari i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, H. Bujar Spahiu, zhvilloi një vizitë pune në Medresenë e Korçës.

Gjatë fjalës së tij në takimin me mësuesit, z. Spahiu, vlerësoi arritjet e Medresesë së Korçës, arsimin cilësor të saj dhe falënderoi mësuesit për kontributin e tyre në edukimin dhe arsimimin e brezit të ri.

Ndërsa drejtori i përgjithshëm i Medreseve të Tiranës, Elbasanit, Kavajës dhe Korçës, z. Ali Zaimi, shprehu mirënjohjen e tij ndaj KMSH-së për mbështetjen e vazhdueshme dhe tha se medresetë do të vazhdojnë të investojnë në rritjen e cilësisë së arsimit dhe edukimit.

Më pas drejtori i Medresesë së Korçës, z. Iljaz Karagoz, tha se Medreseja e Korçës është një shkollë e dashur për të gjithë korçarët dhe zonat përreth. Stafi pedagogjik i përgatitur dhe kushtet bashkëkohore sigurojnë një mësimdhënie cilësore.



Kolegji Universitar Bedër diplomon brezin e 6-të të studentëve

Kolegji Universitar “Bedër” diplomoi brezin e 6-të të studentëve në një ceremoni të organizuar me këtë rast në Amfiteatrin e Tiranës. Tashmë kur janë mbushur tetë vite që nga themelimi, Bedër nxjerr në tregun e punës rreth 260 specialistë të rinj në fushën e Drejtësisë, Komunikimit, Shkencave Islame, Gjuhës dhe Letërsisë Angleze si dhe në fushën e Edukimit.

Përpos studentëve të shumtë të cilët hodhën në ajër kapelet e diplomimit duke mbyllur kështu një etapë mjaft të rëndësishme në jetën e tyre, në këtë ceremoni ishin të pranishëm Rektori i institucionit, Prof. Dr. Ferdinand Gjana, Kryetari i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë z. Bujar Spahiu, Kryetari i Fondacionit “H. Ali Korça”, z. Skender Bruçaj, Kryetari i KLSH-së, z. Bujar Leskaj, biznesmeni Dritan Dulaku, stafi akademik dhe administrativ i “Bedër”, personalitete të shumtë si dhe familjarë e të afërm të të diplomuarve.

Në fjalën e tij përshëndetëse, Kryetari i KMSH-së, H. Bujar Spahiu, vlerësoi Universitetin Bedër për vlerat dhe kontributin e tij, si dhe përgëzoi studentët e pranishëm për mbylljen e këtij cikli studimesh me plot vështirësi dhe i motivoi ata për të vazhduar më tej në rrugën e dijes.

Ndërsa Rektori i Universitetit, z. Gjana, përgëzoi studentët për suksesin e arritur, duke i inkurajuar ata që të përpiqen vazhdimisht në rrugën e dijes, rrugë e cila do t'i forcojë për të përballuar çdo sfidë të jetës.

Aktiviteti vazhdoi më tej me shpërndarjen e certifikatave të ekselencës për studentët e parë të çdo programi studimi, 2 nga të cilët mbajtën fjalën përshëndetëse para të pranishmëve.

Në fund, të gjithë studentët e diplomuar në programet bachelor dhe master u ngjitën në skenë për të hedhur kapelet e diplomimit duke përmbushur me sukses rrugëtimin e tyre në Universitetin “Bedër”.

KLASA

2019



KOLEGJI UNIVERSITAR
BEDËR

KOLEGJI UN

ITAR BED



KOLEGIJ UNIVERSITAR
BEDER

KOLEGIJ

RSITAR BE





BEDËR 2019

CEREMONIA E





DIPLOMIMIT

BEDËR 2019

EXIT

Kryetari i KMSH-së pret në një takim zv/ministrin kuvajtian të vakëfeve

Kryetari i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, H. Bujar Spahiu, priti në një takim zv/ministrin për çështjet kulturore në ministrinë e Vakëfeve dhe Çështjeve Fetare në Kuvajt, z. Daut Al Asusi dhe drejtorin e fondit në ndihmë të të sëmurëve, z. Khalid Al Hindi.

Kryetari i KMSH-së, i shprehu falenderimet ministrit për kontributin që shteti i Kuvajtit ka dhënë në Shqipëri, bashkëpunimin me KMSH-në, ndërtimin e xhamive dhe aktiviteteve të tjera të shumta. Gjithashtu gjatë takimit u diskutua mbi projekte konkrete dhe investime të ndryshme.

Ndërsa, zv/ministri Al Asusi, shprehu gatishmërinë e tij që marrëdhëniet mes institucioneve të forcohen më shumë dhe në të ardhmen të realizohen projekte të përbashkëta në shërbim të besimtarëve dhe qytetarëve.





aktivitete

korrik

Prezantohet Myftiu i ri i Tiranës

Kryetari i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, H. Bujar Spahiu, zhvilloi një takim në selinë e Komunitetit Mysliman me imamët e xhamive të Tiranës, ku prezantoi myftiun e ri të kryeqytetit, z. Lauren Luli.

Gjatë takimit kreu i KMSH-së e vuri theksin në dhënien e një impulsi të ri institucionit të myftinisë. Gjithashtu, z. Spahiu, vlerësoi punën dhe kontributet e deritanishme në këtë myftini.

Myftiu i ri i Tiranës, z. Lauren Luli, është teolog. Ai ka kryer studimet e larta në Fakultetin e Shkencave Islame në Bursa të Turqisë dhe më pas masterin shkencor në Shkencat e Hadithit në KU “Bedër”, Tiranë. Ai ka ushtruar detyrën e tij si imam dhe myfti si dhe prej dy vitesh mbante postin e nënkryetarit të KMSH-së.

Imamët e Myftinisë së Tiranës e mirëpritën emërimin e z. Luli në këtë detyrë si edhe shprehën gatishmërinë për të bashkëpunuar dhe çuar përpara shërbimin fetar në kryeqytetin e vendit.








Imami i Komunitetit Shqiptaro-Amerikan viziton kryetarin e KMSH-së

Kryetari i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, H. Bujar Spahiu, priti në një vizitë në selinë e institucionit, z. Gazmend Aga, Imam i Komunitetit Shqiptaro-Amerikan në Connecticut (AAMC) dhe përfaqësues i KMSH-së në SHBA.

Në fjalën e tij, z. Aga, e vuri theksin mbi unitetin dhe bashkëpunimin që karakterizon marrëdhënien e deritanishme ndërmjet dy palëve. Më tej ai e uroi Kryetarin e KMSH-së për emërimin e tij në krye të institucionit në emër të Komunitetit Mysliman Shqiptaro-Amerikan.

Ndërsa Kryetari Spahiu, pasi e falënderoi atë për vizitën dhe urimet shprehu gatishmërinë e institucionit për të bashkëpunuar më tej në të ardhmen në fusha të ndryshme me interes të përbashkët.





Kreu i KMSH-së pret në takim përfaqësuesin e Shtëpisë së Zekatit në Kuvajt

Kryetari i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, H. Bujar Spahiu, priti në një takim përfaqësuesin e lartë të Shtëpisë së Zekatit në Kuvajt, z. Adil el-Xherij. Kryetari i KMSH-së, i shprehu falënderimet për kontributin që shteti i Kuvajtit ka dhënë në Shqipëri si dhe për bashkëpunimin ndër vite me KMSH-në. Ndërsa, z. Adil el-Xherij, shprehu gatishmërinë e tij që marrëdhëniet mes institucioneve të forcohen më shumë dhe në të ardhmen të realizohen projekte të përbashkëta në shërbim të besimtarëve dhe qytetarëve.





Kreu i KMSH-së merr pjesë në ministerialin e organizuar nga DASH

Kryetari i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, H. Bujar Spahiu, mori pjesë në Ministerialin për Përparimin e Lirisë Fetare.

Ministeriali mbledhi bashkë udhëheqës nga mbarë bota për të diskutuar mbi sfidat e lirisë së besimit dhe për të nxitur më shumë respektin dhe mbrojtjen e lirisë fetare për të gjithë.

Gjatë ministerialit, Kreu i KMSH-së, zhvilloi takime me drejtues fetarë të vendeve të ndryshme, intelektualë dhe studiues.

Ky ministerial u përshëndet nga zv/Presidenti i SHBA-ve, Mike Pence dhe nga Sekretari i Shtetit Amerikan, z. Mike Pompeo.









Drejtori i Projekteve Ndërkombëtare të Qatar Charity viziton KMSH-në

Kryetari i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, H. Bujar Spahiu, priti në një takim Drejtorin e Departamentit të Projekteve Ndërkombëtare pranë Qatar Charity, z. Khalid Abdullah al-Yafie i cili shoqërohej nga Drejtori i Qatar Charity në Shqipëri, z. Shawki Abou Seif.

Diskutimi ndërmjet tyre u ndal në bashkëpunime në fusha të ndryshme si qëllim shërbimin ndaj besimtarëve në mbarë vendin tonë.

Në fjalën e tij, Kryetari i KMSH-së e falënderoi për kontributin mbi 20 vjeçar të Qatar Charity dhe u ndal në konsolidimin e mëtejshëm të marrëdhënieve ndërmjet dy institucioneve.

Bashkëbisedimi vijoi më tej mbi projekte konkrete për të ardhmen.





aktivitete

gusht

Haxhinjtë shqiptarë nisen drejt Mekës e Medines

Rreth 430 besimtarë myslimanë janë nisur drejt vendeve të shenjta të Mekës e Medinës për të kryer ritualin e haxhit për vitin 2019.

Besimtarët që vinin nga myftini të ndryshme të vendit tonë por edhe dhjetëra të tjerë nga Mali i Zi, lanë aeroportin e Rinasit ditën e sotme dhe pritjet të mbërrijnë në Mekë në orët e vona të mbrëmjes, ku më pas do të bëhet akomodimi në hotel për të vijuar me programin 20 ditor.

Besimtarët u përcollën nga Kryetari i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, h. Bujar Spahiu, si dhe përfaqësues të tjerë të institucionit.

Këtë vit ishin rreth 430 besimtarë myslimanë shqiptarë të cilët udhëtuan drejt Mekës për t'iu bashkëngjitur miliona haxhinjve nga e gjithë bota për të kryer ritualin e haxhit.



Kryetari i KMSH-së pret në një takim zyrtaren e DASH

Kryetari i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, H. Bujar Spahiu, priti në një takim, znj. Mariyam Cementwala, këshilltare për politikat dhe iniciativat strategjike të byrosë për lirinë e besimit dhe të të drejtave të njeriut në Departamentin Amerikan të Shtetit.

Kreu i KMSH-së e falënderoi, znj. Cementwala për vizitën dhe e njohu shkurtimisht me historikun, aktivitetin dhe rolin e institucionit në Shqipëri, rajon e më gjerë.

Ndërsa, znj. Cementwala, vlerësoi rolin e KMSH-së në ruajtjen dhe forcimin e bashkëjetesës fetare në Shqipëri.

Gjatë takimit u diskutua për liritë fetare, harmoninë dhe të drejtat e besimit, si të drejta themelore të njeriut.






Nënkryetari i KMSH-së mban hytbe në xhaminë e “Selitës” në Tiranë

Nënkryetari i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, z. Taulant Bica, ka mbajtur hytben e ditës së Premte në xhaminë e “Selitës” në Tiranë.

Gjatë fjalimit të tij ai u fokusua në festën e Kurban Bajramit duke sjellë në vëmendje edhe 10 ditët e Dhul-Hixhes dhe Haxhin të cilat lidhen ngushtë me Kurban Bajramin.

“Dita e Arafatit përmban sekrete dhe vlera të mëdha aq sa Profeti i Nderuar Muhamedi (a.s) është shprehur se “Haxhi është Arafat”, duke nënkuptuar se pa qëndrimin në Arafat haxhi i besimtarit nuk quhet i plotësuar. Arafati është momenti që Allahu ka zgjedhur për të pranuar lutjet e besimtarëve më shumë se kurdo tjetër, duke zbritur mëshirën e tij mbi njerëzit, prandaj kush vërtet i drejtohet Krijuesit në Arafat, nuk kthehet asesi duarbosh prej Tij. Sepse për nga afërsia me Zotin, kjo ditë i përngjet sexhdes që është momenti kur njeriu është më pranë Zotit.” – tha ai gjatë kësaj hytbeje.



Besimtarët myslimanë festojnë Kurban Bajramin

Ceremonia e faljes u zhvillua në sheshin “Skënderbej”, Tiranë, ku mijëra besimtarë myslimanë falën namazin e Kurban Bajramit dhe qindra mijëra të tjerë kanë festuar dhe kryer faljen në sheshet e çdo qyteti të vendit.

Festimet e kësaj dite filluan që në orët e para të mëngjesit me faljen e përbashkët të namazit të sabahut.

Para faljes së namazit të Kurban Bajramit, besimtarët ndoqën një program të shkurtër, program i cili filloi me këndimin e një pjese të Kur’anit famëlartë nga Hafizi Enes Hyka.

Ceremonia vazhdoi më tej me fjalën përshëndetëse të kryetarit të Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, H. Bujar Spahiu, i cili uroi besimtarët myslimanë dhe gjithë shqiptarët kudo që ndodhen për festën e Kurban Bajramit.

Ndërsa nënkryetari i KMSH-së, z. Taulant Bica, mbajti ligjëratën para faljes së namazit të Kurban Bajramit.

Falja e Namazit të Kurban Bajramit u drejtua nga kryetari i Komunitetit Mysliman H. Bujar Spahiu, i cili më pas mbajti edhe hytben për besimtarët e pranishëm.

Ndërsa Drejtori i Kulturës në KMSH, z. Dorian Demetja, i cili moderoi programin, u shpreh se Kurban Bajrami është festa e mirësisë, bashkëpunimit, vëllazërimit dhe e mirënjohjes. Kurban Bajrami është një festë për të gjithë, prandaj ti ndajmë të mirat materiale e shpirtërore me të afërmit tanë dhe nevojtarët.

Në fund, besimtarët shkëmbyen mes tyre urimet më të përzemërta për këtë festë të dashurisë dhe sakrificës. Mes urimesh dhe lutjesh besimtarët u larguan nga sheshi për të kryer obligimin e prerjes së kurbanit si dhe për të kryer vizita tek të afërmit e tyre.



GËZUAR BAJRAMIN!





GËZUAR BAJRAMIN!





Personalitete të vendit urojnë besimtarët për Kurban Bajram

Menjëherë pas përfundimit të programit të Kurban Bajramit në “Sheshin Skënderbej”, Komuniteti Mysliman i Shqipërisë hapi dyert për të pritur vizita me rastin e kësaj feste.


Për të përcjellë mesazhet e urimit në Komunitetin Mysliman ishin kryebashkiaku i Tiranës, z. Erion Velaj, kryetarja e Komitetit Shtetëror për Kultet, znj. Loreta Aliko, nënprefekti i Tiranës, drejtues të institucioneve shtetërore, lokale, përfaqësues të subjekteve politike, ambasadorë, personalitete të jetës publike, të fushës së artit, medias, biznesit, etj.

Pjesë e kësaj dite të begatë e festive u bënë edhe drejtues të komuniteteve fetare, Kreu i Kishës Ortodokse, Anastas Janullatos, Kreu i Kishës Katolike, George Frendo, dhe Kryegjyshi Botëror i Bektashinjve, Haxhi Dede Edmond Brahimaj, përfaqësues nga Vëllazëria Ungjillore Shqiptare si dhe përfaqësues të tarikateve, Kryetari i Tarikatit Rufai, Shejh Qemaludin Reka dhe Kryetari i Tarikatit Kadiri, Shejh Bujar Harasani.

Në mesazhet e tyre drejtuar Kryetarit të Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, H. Bujar Spahiu, ata shprehën urimet dhe përshëndetjet e tyre të sinqerta si dhe uruan besimtarët për më shumë mirësi në familje dhe shoqërinë tonë të përbashkët.









KMSH shpërndan mijëra kurbane në të gjithë vendin

Komuniteti Mysliman i Shqipërisë, nëpërmjet myftinive në rrethe kanë shpërndarë mijëra kurbane me rastin e festës së Kurban Bajramit. Pakot me mishin e kurbanit u janë shpërndarë familjeve të varfra, fëmijëve jetimë, paraplegjikëve, tetraplegjikëve, familjeve në gjak, etj. Nismës së përvitshme të KMSH-së i janë bashkuar gjithashtu organizata dhe fondacione të ndryshme humanitare që operojnë në Shqipëri.



sl

aktivitete

ntator

Përfaqësuesi i Ministrisë për Çështjet Islame të Arabisë Saudite viziton KMSH-në

Kryetari i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, H. Bujar Spahiu, priti në një takim në selinë e institucionit, z. Selman el-Uthman, përfaqësues i lartë i Ministrisë për Udhëzimin dhe Çështjet Islamike të Arabisë Saudite.

Ky takim vjen në kuadër të organizimit të një vizite të kryetarit të KMSH-së me një delegacion shoqërues në Arabinë Saudite me ftesë të ministrit të kësaj ministrie.

Në fjalën e tij, kryetari Spahiu, u ndal në historikun e institucionit dhe zhvillimet më të rëndësishme të Islamit në vendin tonë.

Ndërsa, z. Selman el-Uthman, përcolli përshëndetjet e institucionit që ai përfaqëson dhe vuri theksin mbi marrëdhënien e mirë që karakterizon bashkëpunimin e deritanishëm mes KMSH-së dhe Arabisë Saudite.





Kryetari i KMSH-së mban hytben në xhaminë e qendrës, Kavajë

Kryetari i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, H. Bujar Spahiu, i shoqëruar nga Nënkryetari i Institucionit, z. Taulant Bica, vizituan xhaminë e qendrës së qytetit të Kavajës, ku mbajtën respektivisht hytben e xhumasë dhe vazën para namazit.

Gjatë kësaj vizite ata u pritën nga Myftiu i qytetit, z. Besnik Leçini.

Në vazën e mbajtur para faljes së namazit të xhumasë, Nënkryetari Bica, trajtoi për dhjetëra besimtarët e pranishëm temën: “Rëndësia e adhurimeve në jetën e besimtarit, veçanërisht namazi”.

Më tej, Kryetari i KMSH-së, z. Spahiu mbajti hytben e xhumasë në të cilën trajtoi temën: “Falënderimi, virtyt i paçmuar”. Duke ju referuar disa haditheve, ajeteve Kuranore dhe dijetarëve myslimanë në konceptimin e falënderimit ai parashtroi për besimtarët e pranishëm argumenta të shumta përse njeriu duhet të jetë vazhdimisht falënderues e mirënjohës ndaj Zotit të Gjithësisë.

Pas përfundimit të hytbes, Kryetari i KMSH-së vijoi më tej me faljen e namazit të xhumasë ku ishin të pranishëm një numër i konsiderueshëm besimtarësh.



Ambasadorja e Palestinës në Tiranë viziton KMSH-në

Kryetari i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, H. Bujar Spahiu, priti në selinë e institucionit Ambasadoren e Palestinës, znj. Hana A.S. Shawa. Në fjalën e tij, kryetari Spahiu, e njohu atë me aktivitetin e KMSH-së ndër vite dhe rolin që ky institucion ka në ruajtjen e stabilitetit dhe zhvillimin e qëndrueshëm të shoqërisë shqiptare. Nga ana e saj, Ambasadorja znj. Shawa, vlerësoi qëndrimet e Komunitetit Mysliman në ruajtjen dhe promovimin e mëtejshëm të harmonisë ndërfetare të vendit dhe rolin e tij aktiv në promovimin e vlerave të besimit. Bashkëbisedimi vazhdoi më tej duke prekur një sërë tematikash me interes të përbashkët.





Dr. Rexhep Boja, ish-kryetar i BIK viziton KMSH-në

Kryetari i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, H. Bujar Spahiu, priti në një vizitë në selinë e institucionit, Dr. Rexhep Boja, Këshilltari Aktual i Zëvendës Kryeministrit të Kosovës si dhe ish-kryetar i Bashkësisë Islame dhe ish-ambasador i Republikës së Kosovës në Arabinë Saudite.

Bashkëbisedimi i tyre u përqendrua mbi një sërë tematikash aktuale që prekin jetën fetare, sociale dhe kulturore të shqiptarëve brenda dhe jashtë kufijve të Shqipërisë e Kosovës.

Në fjalën e tij, z. Boja, u ndal në marrëdhënien e mirë që karakterizon të dy vendet si në rang politik po ashtu në atë shoqëror e fetar.

Ndërsa z. Spahiu, pasi e falënderoi z. Boja për vizitën e njohu atë me vizionin dhe punën konkrete të KMSH-së për të qenë vazhdimisht një faktor i rëndësishëm në ruajtjen e stabilitetit shoqëror të vendit.





Nënkryetari i KMSH-së uron vitin e ri shkollor nga Medreseja e Tiranës

Nënkryetari i KMSH-së, z. Taulant Bica, mori pjesë në ceremoninë e fillimit të vitit të ri shkollor 2019-2020 në Medresenë e Tiranës, ku uroi të gjithë nxënësit, mësuesit dhe prindërit për një vit sa më të mbarë dhe plot suksese. Ndërsa në fjalën e tij përshëndetëse drejtori i Medresesë së Tiranës, z. Ali Zaimi, tha se dija dhe të mësuarit është vlerësuar e nxitur nga librat e shenjtë, profetët dhe nga më të shquarit e historisë njerëzore si dhe i uroi nxënësit për një vit të suksesshëm.

Gjithashtu viti i ri shkollor ka nisur edhe në Medresenë e Shkodrës, “H. Sheh Shamia”, Medresenë e Kavajës, “Hafiz Ali Korça”, Medresenë e Durrësit, “Mustafa Varoshi”, Medresenë e Elbasanit, “Liria”, dhe Medresenë e Korçës, “Abdullah Zëmbaku”.

Medresetë ofrojnë arsimim dhe edukim për ciklin 9-vjeçar dhe të mesëm.

Medresetë mundësojnë shkollimin e nxënësve në kushte bashkëkohore dhe me cilësi të lartë mësimdhënie. Medresetë njihen për suksesin e tyre në arenën kombëtare dhe atë ndërkombëtare. Në këto shkolla nxënësit kanë mundësinë e shkollimit cilësor duke ndërthurur shkencën me besimin.





KMSH i vjen në ndihmë familjes Lita

Komuniteti Mysliman i Shqipërisë me anë të Myftinisë së Tiranës organizoi thirrjen për donacione në të gjitha xhamitë e kryeqytetit për rastin e Drilon Litës, i cili vuante nga leucemia akute dhe kërkohet ndërhyrje urgjente në spitale më të specializuara jashtë vendit.

Shuma e mbledhur nga donacioni i besimtarëve nëpër xhami i është dorëzuar familjes Lita nga Myftiu, z. Lauren Luli, i cili ishte për vizitë tek familja në fshatin Sllovë të Peshkopisë ku i uroi shërim sa më të shpejtë Drilonit.

Familjarët e Drilonit e falënderuan myftiun për mbështetjen e dhënë si dhe shprehën mirënjohjen dhe falënderimin e tyre të thellë për të gjithë ata kontribuar për djalin e tyre.

Driloni momentalisht ndodhet në një spital në Bergamo të Italisë ku po ndjek kurimin dhe gjendja e tij shëndetësore është në përmirësim.

KMSH falënderon të gjithë ata që kanë kontribuar në shërimin e tij.



Kreu i KMSH-së takon ministrin e çështjeve fetare dhe vakëfeve në Egjipt

Kryetari i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, H. Bujar Spahiu, zhvilloi një takim me z. Muhamed Muhtar Xhum'a, ministër i çështjeve fetare dhe vakëfeve në Egjipt.

Gjatë takimit u diskutua për rritjen e bashkëpunimit mes dy institucioneve dhe shkëmbimin e eksperiencave me interes të përbashkët.

Gjithashtu kreu i KMSH-së zhvilloi një takim edhe me z. Mohamed Bin Rashed Al-Halife, zëvendës i këshillit të lartë të çështjeve islame në Bahrejn.





Kryetari i KMSH-së mban hytben në xhaminë e qendrës, Kamëz

Kryetari i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, H. Bujar Spahiu, vizitoi xhaminë e qendrës, Kamëz, ku mbajti edhe hytben e xhumasë me temë: “Njeriu është me atë që do”.

Në këtë hadith Profeti ynë shpjegon më së miri se njeriu si në këtë botë, por edhe në botën e përtejme do të jetë vazhdimisht me ata që do, në cilindo skaj qoftë, pozitiv apo negativ. Ai që do të jetë së bashku me profetët, me njerëzit besnik dhe të drejtë, më parë duhet t'i dojë ata, pastaj duhet t'i bëjë natyrë brenda vetes karakteristikat e atributet e tyre.

Kryetari Spahiu, e ilustroi fjalimin e tij me shembuj të ndryshëm nga jeta e Profetit Muhamed s.a.s, për ta bërë sa më konkrete temën në përditshmërinë tonë. Pas përfundimit të hytbes, kryetari i KMSH-së vijoi më tej me faljen e namazit të xhumasë ku ishin të pranishëm një numër i konsiderueshëm besimtarësh.



Kreu i KMSH-së takim me zv/presidentin e Federatës Universale të Paqes

Kryetari i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, H. Bujar Spahiu, priti në një takim, z. Jacques Marion, zv/president i Federatës Universale të Paqes për Evropën dhe Lindjen e Mesme.

Kreu i KMSH-së e falënderoi z. Marion për vizitën dhe e njohu shkurtimisht me historikun, aktivitetin dhe rolin e institucionit në Shqipëri, rajon dhe më gjerë.

Ndërsa, z. Marion, e njohu kryetarin e KMSH-së mbi aktivitetet e Federatës Universale të Paqes të organizuara në disa vende të ndryshme.

Gjatë takimit kryetari i KMSH-së dhe z. Marion, diskutuan mbi harmoninë dhe bashkëjetesën fetare në Shqipëri dhe më gjerë, si dhe mbi faktorët që ndikojnë pozitivisht tek bashkëjetesa, harmonia dhe paqja.







Myftiu i Tiranës merr pjesë në 40-vjetorin e Xhamisë Boshnjako-Shqiptare në Frankfurt

Myftiu i Tiranës, z. Lauren Luli, mori pjesë në ceremoninë e 40-vjetorit të themelimit të Qendrës dhe Xhamisë Boshnjako-Shqiptare në Frankfurt si dhe në 30-vjetorin e punës së imamatit të kësaj xhamie, z. Ahmed Kajoshaj.

Në fjalën e tij përshëndetëse, myftiu, në emër të KMSH-së dhe kryetarit e përgëzoi imamin dhe kryesinë e kësaj xhamie si dhe theksoi se këto institucione janë baza ku ruhet besimi, kultura, vëllazëria dhe harmonia.

Në këtë aktivitet morën pjesë përfaqësues të bashkësive islame të Shqipërisë, Bosnje-Hercegovinës, Kosovës, Maqedonisë, dhe Malit të Zi, si dhe përfaqësues të qendrave islame Shqiptare në Gjermani.



aktivitete

tetor

Zhvillohet konferenca mediatike: “Radiot fetare në gjuhën shqipe”

Autoriteti i Mediave Audiovizive zhvilloi në ambientet e Hotel “Rogner” në Tiranë, konferencën mediatike me temë: “Radiot fetare në gjuhën shqipe”.

Kjo konferencë mbledhi sëbashku përfaqësues të radiove dhe komuniteteve fetare të vendit, ekspertë dhe studiues të medias, deputetë, drejtues të institucioneve publike si dhe dhjetëra gazetarë apo specialistë të fushës së komunikimit.

Qëllimi i këtij organizimi ishte nxjerrja në pah apo promovimi i rolit dhe kontributit të redaksive fetare të komunitetit, në promovimin e tolerancës dhe bashkëjetesës mes besimeve fetare.

Ndër të tjerë, konferencën e përshëndeti edhe Nënkryetari i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, z. Taulant Bica, i cili gjatë fjalës së tij vlerësoi punën e AMA-s në kontributin e që ky institucion jep në zhvillimin e radiove të komuniteteve fetare të vendit.

Konferenca vijoi më tej me prezantimin e radiove fetare nga drejtuesit përkatës. Si i tillë, z. Agron Hoxha, Drejtor i “Radio Spektrum” (Radio e Komunitetit Mysliman të Shqipërisë) i njohu të pranishmit me aktivitetin e kësaj radioje. Më tej ai u ndal në përmbajtjen, strukturën programore, misionin dhe vizionin që kjo radio përcjell te çdo besimtar gjatë transmetimit ditor. Në sesionin përmbyllës të konferencës u diskutua mbi tematika të ndryshme aktuale që prekin tregun e transmetimeve audiovizive.









Kreu i KMSH-së mban hytbe në xhaminë “Mbret” në Elbasan

Kryetari i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, H. Bujar Spahiu, dhe nënkryetari, z. Taulant Bica, vizituan xhaminë “Mbret” në Elbasan.

Kryetari Spahiu, në hytben e namazit të xhumasë u fokusua tek morali dhe ndjesia e ndrojtjes ndaj Zotit ndërsa nënkryetari në ligjëratën e tij foli mbi meditimimin rreth krijesave të Allahut.

Në fund u zhvillua një vizitë edhe në ambientet e myftinisë, ku myftiu i Elbasanit, z. Agim Duka, e njohu kryetarin më nga afër mbi ecurinë dhe mbarëvajtjen e punëve në këtë myftini.







Komisioneri për Mbrojtjen nga diskriminimi viziton KMSH-në

Kryetari i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, H. Bujar Spahiu, priti në një takim Komisionerin për Mbrojtjen nga Diskriminimi, z. Robert Gajda. Gjatë këtij takimi, z. Gajda, e njohu kryetarin me aktivitetin e institucionit që ai drejton si dhe me raste të ndryshme të diskriminimit në shoqëri për arsye të ndryshme racore, fetare, fizike, etj. Ndërsa, kryetari i KMSH-së, z. Spahiu, u shpreh i gatshëm për të intensifikuar bashkëpunimin mes institucioneve si dhe shprehu shqetësimin e tij për rastet e diskriminimit fetar.







Nënkryetari i KMSH-së mban hytbe në xhaminë e qendrës në Librazhd

Nënkryetari i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, z. Taulant Bica, mbajti hytben e ditës së premtë në xhaminë e qendrës në qytetin e Librazhdit. Gjatë hytbes ai foli mbi meditimimin i cili e shtyn njeriun drejt shtimit të adhurimit.

“Meditimi i shëndoshë patjetër që duhet ta dërgoi njeriun në adhurim. Sepse njeriu pa adhurim ndaj Krijuesit të tij është jashtë qëllimit të krijimit.” – tha ai gjatë fjalës së tij.

Gjithashtu, nënkryetari zhvilloi edhe një vizitë në Myftininë e Librazhdit ku u prit nga myftiu i këtij qyteti, z. Ardit Hoxhllaku.

Gjatë këtij takim u diskutua mbi ecurinë e punëve dhe aktivitetin e kësaj myftinie.



KU “Bedër” hap dyert për vitin e ri akademik 2019-2020

Kryetari i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, H. Bujar Spahiu, ishte i pranishëm në ceremoninë e hapjes së vitit të ri akademik të Kolegjit Universitar “Bedër”.

Ky aktivitet mbledhi sëbashku stafin akademik dhe administrativ të “Bedër”, përfaqësues të institucioneve të ndryshme, prindër si dhe studentë të rinj dhe aktual të institucionit.

Ceremonia filloi me fjalën përshëndetëse të Rektorit të KU “Bedër”, Prof. Dr. Ferdinand Gjana, i cili pasi ju uroi mirëseardhjen të pranishmëve u ndal në historikun e institucionit.

Ndërsa Kryetari i KMSH-së, z. Spahiu, u ndal në rëndësinë që duhet ti japin studentët të mësuarit jo vetëm në kontekstin profesional por edhe në atë moral e njerëzor. Më tej ai u ndal në mbështetjen e vazhdueshme të Komunitetit Mysliman të Shqipërisë ndaj KU “Bedër” si institucioni më i lartë arsimor i KMSH-së.

Ceremonia vazhdoi më tej me fjalët përshëndetëse të dekanëve dhe disa prej studentëve aktual të institucionit.













Rikthehet cikli i mbrëmjeve fetare “Frytet e besimit”

Cikli i mbrëmjeve fetare “Frytet e Besimit” u zhvillua në xhaminë “Paskuqan 2” Tiranë, duke filluar kështu sezonin e ri të referimeve me tematika të ndryshme fetare me besimtarët myslimanë në mbarë vendin. Të ftuarit e parë në këtë cikël takimesh me besimtarët ishin Kryetari i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, H. Bujar Spahiu dhe Myftiu i Tiranës, z. Lauren Luli.

Në referimin e tij Kryetari Spahiu ndau me besimtarët e pranishëm moralin e bukur që duhet të karakterizojë çdo besimtar në jetën e përditshme. Duke i'u referuar shembullit më të përkryer të njerëzimit, Profetit fisnik, ai nxori në pah për të gjithë të pranishmit disa nga cilësitë më të bukura të moralit që duhet të karakterizojë çdo besimtar në mënyrën sesi duhet të jetojë Islamin.

Më tej ishte radha e Myftiut të Tiranës, z. Luli, të referonte mbi rëndësinë që ka praktikimi i traditës së Profetit në jetën tonë. Sipas tij, rifreskimi i besimit është detyrë e gjithsecilit nga ne për të mbajtur lart vlerat e besimit dhe të praktikumit të Islamit.

Programi vazhdoi më tej me llahinë e interpretuar nga Imami i xhamisë z. Ramiz Mziu dhe u mbyll me duanë e imanit të po kësaj xhamie z. Munir Salkurti.





Inaugurohet xhamia e re “Arrameras” në Fushë- Krujë

Në një atmosferë të ngrohtë shpirtërore, me lexim Kur’ani, ilahi dhe me përshëndetjen e të ftuarve u hapën dyert e xhamisë më të re në Fushë-Krujë.

Në ceremoninë e hapjes ishin të pranishëm kryetari i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, H. Bujar Spahiu, kryetari i Bashkësisë Fetare Islame të Maqedonisë së Veriut, z. Sulejman Rexhepi, myftiu i Krujës, z. Erjol Haxhiu, myftiu i Tiranës, z. Lauren Luli, sekretari i përgjithshëm i Bashkisë së Krujës, z. Florin Cerhozi, përfaqësues të shoqatave të ndryshme, myftinj, imamë dhe besimtarë të shumtë.

Në fjalën e tij përshëndetëse kryetari i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, H. Bujar Spahiu, falënderoi donatorët, institucionet dhe të gjithë kontribuuesit për ndërtimin e kësaj xhamie. Ai shtoi se xhamia është një vatër edukimi dhe në themelin e saj qëndron dashuria, respekti dhe adhurimi ndaj Allahut.

Protokolli i përshëndetjeve vazhdoi më tej me myftiun e Krujës, z. Erjol Haxhiu, z. Sulejman Rexhepi, z. Florin Cerhozi, si dhe kryetarin e shoqatës “Mirënjohja”, z. Gëzim Abdishahu.

Më pas u pre shiriti i inaugurimit dhe u fal xhumaja e parë.







Kryetari i KMSH-së mer pjesë në Samitin e Paqes për Evropën Juglindore

Kryetari i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, H. Bujar Spahiu, mori pjesë në Samitin e Paqes për Evropën Juglindore me temë: “Paqja, Siguria dhe Zhvillimi njerëzor në Evropën Juglindore”, samit i cili u zhvillua më 25 dhe 26 tetor në Tiranë.

Në këtë samit morën pjesë personalitete të nivelit të lartë, përfshi krerë aktual dhe të mëparshëm shtetesh dhe qeverish, parlamentarë, udhëheqës fetarë, drejtues të shoqërive civile, si dhe një numër i konsiderueshëm figurash nga fusha të ndryshme, të cilët gjatë punimeve të samitit trajtuan çështje të ndryshme me rëndësi, me qëllim gjetjen e zgjidhjeve që na çojnë drejt paqes afatgjatë dhe zhvillimit të qëndrueshëm në Evropën Juglindore e më gjerë. Ndërsa paneli i të ftuarve të nderit përbëhej nga Humanitarja dhe Bashkëthemeluesja e “Federatës Universale të Paqes” znj. Hak Ja Han Moon, ish-Presidenti i Republikës së Shqipërisë, z. Alfred Moisiu, Presidenti i Republikës së Kosovës, z. Hashim Thaçi, Presidenti i Maqedonisë së Veriut, z. Stevo Pendarovski si dhe Deputetja dhe Nënkryetarja e Grupit Parlamentar Socialist të Shqipërisë, znj. Elisa Spiropali.

Samiti vazhdoi punimet më tej me referime të të pranishmëve në ambientet e “Hotel Tirana”. Seancë në të cilën kryetari i KMSH-së, z. Spahiu, referoi mbi temën: “Adresimi i sfidave kritike të kohës sonë: Roli i liderëve të besimit.”

Gjatë fjalës së tij ai u fokusua mbi shembullin e Islamit në zgjidhjen e sfidave të përditshme si besimtarë dhe si qytetarë të shoqërisë së përbashkët njerëzore. Më tej ai ndau me të pranishmit harmoninë dhe bashkëjetesën ndërfaqetare të Shqipërisë si një shembull pozitiv për t’ja servirur mbarë botës.

Punimet e samitit vazhduan më tej me referime të shumta të referuesve që morën pjesë nga e gjithë bota.







“Frytet e Besimit” zhvillohen në xhaminë e Sahatit, Berat

Cikli i mbrëmjeve fetare “Frytet e Besimit” u zhvillua në xhaminë e Sahatit në Berat.

Programi filloi me leximin e ajeteve Kur’anore nga mësuesi i Kur’anit në Medresenë e Elbasanit, z. Klodian Tafani.

Për të ligjëruar ishin të pranishëm nënkryetari i KMSH-së, z. Taulant Bica dhe myftiu i Vlorës, z. Bilal Bodlli.

Nënkryetari i KMSH-së në ligjëratën e tij u fokusua në cilësitë e besimtarit, duke theksuar disa nga cilësitë të cilat përmenden në Kur’an dhe në Hadithe. Ai gjithashtu tha se njeriu si krijesë e mrekullueshme e Zotit, ka një rol të veçantë në këtë jetë.

Ndërsa Myftiu i Vlorës shtjelloi disa pika të cilat një besimtar duhet t’i ketë kujdes siç janë: falja e namazit në mënyrën më të mirë, ndarja e pasurisë, shmangia nga veprat e kota pa dobi si gënjeshtër, thashethemi, etj, ruajtja e nderit, amanetit, premtimit dhe vazhdimësia në punë të mira.

Në fund të programit myftiu i Beratit, z. Baftjar Këllezi, falënderoi ligjëruesit dhe theksoi rëndësinë dhe mesazhet që përcillen në këto takime.



Nënkryetari i KMSH-së pret në një takim drejtorin e KMBFGR-së në Maqedoninë e Veriut

Nënkryetari i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, z. Taulant Bica, priti në një takim drejtorin e Komisionit për Marrëdhëniet me Bashkësitë Fetare dhe Grupet Religjioze në Republikën e Maqedonisë së Veriut (KMBFGR), z. Darijan Sotirovski.

Drejtori i KMBFGR-së prezantoi institucionin që përfaqëson dhe tha se Shqipëria është një model sukcesi në rajon dhe më gjerë në harmoninë, bashkëjetësën dhe bashkëpunimin mes komuniteteve fetare.

Ndërsa nënkryetari i KMSH-së, z. Bica, e falënderoi atë për vizitën dhe e njohu me veprimtarinë e Komunitetit Mysliman.

Drejtori i KMBFGR-së gjatë kësaj vizite shoqërohej nga ambasadori i Republikës së Maqedonisë së Veriut në Tiranë.





Kreu i KMSH-së zhvillon vizitë zyrtare në Arabinë Saudite

Kryetari i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, H. Bujar Spahiu, i shoqëruar nga drejtori i Vakf- Investimeve, z. Edison Hoti, Myftiu i Tiranës, z. Lauren Luli dhe këshilltari për Marrëdhëniet me Botën Arabe dhe Islame, z. Xhemal Saferti, zhvilluan një vizitë zyrtare në Arabinë Saudite.

Kjo vizitë u organizua me nismë të ministrit për Çështjet Islame në Arabinë Saudit, z. Abdul-Latif Al-Sheikh, i cili disa muaj më parë ftoi kreun e KMSH-së për të zhvilluar një vizitë zyrtare në Arabinë Saudite. Gjatë takimit me z. Abdul-Latif Al-Sheik në ministrinë e Çështjeve Islame është firmosur memorandum i bërëbashkët mes dy institucioneve.

Kreu i KMSH-së theksoi në takim se Shqipëria është një shembull i jashtëzakonshëm i përcjelljes së Islamit të drejtë, me vlerat më të larta që ai përfaqëson si dhe u ndal tek harmonia dhe bashkëjetesa fetare. Ndërsa ministri Abdul-Latif Al-Sheikh përgëzoi kreun e KMSH-së për qëndrimet e sakta dhe ekuilibruese të mbajtura nga institucioni, duke i shprehur edhe mbështetjen e tij institucionale.







n


aktivitete

menton



Kreu i KMSH-së takim me presidentin e Bankës Islamike për Zhvillim

Takimi i radhës i kreut të KMSH-së, H. Bujar Spahiu, në Arabinë Saudite ka qenë me presidentin e Bankës Islamike për zhvillim, Dr. Bandar Hajjar. Gjatë këtij takimi u diskutua mbi projekte dhe bashkëpunime të ndryshme në disa fusha. Kreu i KMSH-së shprehu dëshirën e bashkëpunimit dhe investimit të Bankës Islamike për Zhvillim në dobi të besimtarëve dhe shoqërisë në Shqipëri. Ndërsa Dr. Hajjar, e falënderoi kreun e KMSH-së dhe tha se Banka Islamike do t'i marrë në konsideratë të gjitha projektet e Komunitetit Mysliman me dëshirën dhe vullnetin e mirë për t'i konkretizuar ato.





Kreu i KMSH-së takim me sekretarin e përgjithshëm të qendrës “Mbreti Selman”

Në kuadër të vizitës disa ditore në Mbretërinë e Arabisë Saudite, delegacioni i KMSH-së, me në krye kryetarin, H. Bujar Spahiu, ka zhvilluar një takim me Dr. Abdullah bin Abdulaziz Al-Rabiah, sekretarin e përgjithshëm të Qendrës Bamirëse dhe Humanitare “Mbreti Selman”.

Gjatë takimit, të dy palët diskutuan mbi intensifikimin e marrëdhënieve midis Qendrës Bamirëse dhe Humanitare “Mbreti Selman” dhe Komunitetit Mysliman të Shqipërisë në fushën e bamirësisë, projektet humanitare dhe më gjerë.



Kryetari i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë zhvillon takime me zyrtarë të lartë në Mbretërinë e Arabisë Saudite

Gjatë kësaj vizite u zhvilluan takime me ministrin për Çështjet Islame në Arabinë Saudit, z. Abdul-Latif Al-Sheikh, zv/ministrin e Haxhit dhe Umres, Dr. Abdulfetah bin Sulejman Meshat, zv/ministrin e Arsimit, z. Abdurrahman bin Nasir el-Kharif, sekretarin e përgjithshëm të Qendrës Bamirëse dhe Humanitare “Mbreti Selman”, Dr. Abdullah bin Abdulaziz Al-Rabiah, presidentin e Bankës Islamike për Zhvillim, Dr. Bandar Hajjar, Akademinë Ndërkombëtare të Fikhut, Universitetin Islam të Medinës dhe Kompleksin e shtypshkronjës së Kuranit Famëlartë “Mbreti Fahd”. Në këtë vizitë pune u diskutua mbi çështje të ndryshme dhe mbi rritjen e bashkëpunimit dypalësh.

Këto takime u përmbyllën në mënyrën më të mirë të mundshme, me një vizitë në Xhaminë e Profetit (as) në Medinë. Delegacioni i KMSH-së u prit nga imami i xhamisë “Mesxhid en-Nebeui” dhe u shoqërua në disa pjesë të xhamisë ku u njohëm më me detaje mbi disa karakteristika të kësaj xhamie.









Vijojnë vizitat dhe takimet në Mbretërinë e Arabisë Saudite

Në kuadër të vizitës në Mbretërinë e Arabisë Saudite Kryetari i KMSH-së, H. Bujar Spahiu zhvilloi takime me zv/ministrin e Haxhit dhe Umres, Dr. Abdulfetah bin Sulejman Meshat dhe me zv/ministrin e Arsimit, z. Abdurrahman bin Nasir el-Kharif.

Gjatë takimit me këtë të fundit, Kreu i KMSH-së e njohu me aktivitetin e Medreseve në të gjithë vendin dhe Universitetin “Bedër” si dhe me punën që KMSH bën për të rritur kapacitetet në fushën e arsimit dhe edukimit në vend. Ndërsa në takimin me zv/ministrin e Haxhit dhe Umres, diskutuan mbi organizimin e haxhit për të gjithë besimtarët shqiptarë.







Angazhimi i të rinjve për ndërtimin e një komuniteti të qëndrueshëm

Komuniteti Mysliman i Shqipërisë në bashkëpunim me Ambasadën Amerikane në Tiranë, zhvilluan konferencën hapëse të projektit të ri, me temë: “Angazhimi i të rinjve për ndërtimin e një komuniteti të qëndrueshëm”.

Ky projekt, i 3-ti radhazi i organizuar në llojin e tij, mbështetet financiarisht nga Ambasada e SHBA-ve në Tiranë dhe konsiston në zhvillimin e një sërë aktiviteteve ndërkulturore, takime të drejtpërdrejta, seminare apo workshope me të rinj në mbarë territorin e vendit tonë.

Në konferencën hapëse të këtij projekti, të zhvilluar në ambientet e “Hotel Tirana”, ishin të pranishëm Kryetari i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, H. Bujar Spahiu, E Ngarkuara me Punë e Ambasadës Amerikane në Tiranë, znj. Leyla Moses-Ones, si dhe Kryetarja e Komitetit Shtetëror të Kulteve, znj. Loreta Aliko.

Pasi falënderoi të pranishmit për pjesëmarrjen dhe Ambasadën e SHBA-ve për zhvillimin e projektit të 3-të radhazi në promovimin e tolerancës dhe mirëkuptimit, Kryetari i KMSH-së, H. Bujar Spahiu, u ndal në sfidat dhe angazhimin e institucionit në përpjekjet kundër çdo lloj forme të ekstremizmit, për ti dhënë shoqërisë shqiptare frytet e harmonisë dhe bashkëjetesës.

Më tej, të pranishmit i përshëndeti edhe e Ngarkuara me Punë e Ambasadës, znj. Leyla Moses-Ones, e cila vlerësoi punën e vazhdueshme të KMSH-së në edukimin e brezave të rinj me frymën e duhur të bashkëjetesës në shoqërinë e përbashkët shqiptare.

Më tej ishte radha e znj. Loreta Aliko, Kryetare e Komitetit Shtetëror të Kulteve të ndante me të pranishmit rëndësinë e zbatimit të këtij projekti në mesin e brezave të rinj.

Konferenca vazhdoi punimet e saj me sesione të tjera ku u diskutuan një sërë tematikash aktuale dhe implementimi i zgjidhjeve më të mira të mundshme në përballjen e përditshme me këto fenomene.







Mblidhet Këshilli i Përgjithshëm i KMSH-së

Këshilli i Përgjithshëm i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë u mbledh në ambientet e Medresesë së Tiranës, ku ka zhvilluar mbledhjen e zakonshme për 6 mujorin e dytë të vitit 2019.

Takimi u hap me këndimin e ajeteve kur'anore nga Myftiu i Tiranës, z. Lauren Luli.

Më pas mbledhja ka vazhduar sipas rregullores statutoe, me listë prezencën dhe prezantimin e raporteve.

Kryetari i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, H. Bujar Spahiu, përshëndeti të gjithë anëtarët e rinj të Këshillit të Përgjithshëm dhe ju uroi atyre suksese në detyrat dhe përgjegjësitë e tyre.

Në mbledhje është bërë konstituimi i Këshillit të Përgjithshëm, u votua për Kryetarin e ri të Këshillit të Përgjithshëm, ku është rizgjedhur për ta drejtuar në katër vitet e ardhshme, Myftiu i Kukësit z. Islam Hoxha dhe janë votuar drejtuesit dhe anëtarët për komisionet e përhershme të këtij këshilli.

Raporti i mbajtur nga kancelari i KMSH-së, z. Ylli Cikalleshi, ka evidentuar dhe nxjerrë në pah aktivitetin e përgjithshëm të drejtorive të KMSH-së, funksionimin e instancave të institucionit në nivel qendror dhe vendor, sfidat, problemet dhe pengesat që janë hasur gjatë gjashtë mujorit të fundit.

Këshilli i Përgjithshëm u informua me vendimet që Kryesia e Komunitetit Mysliman ka marrë gjatë kësaj periudhe si dhe emërimet dhe lëvizjet e kryera gjatë këtij viti, të cilat më pas janë miratuar nga KP, së bashku me raportin e Kryesisë së KMSH-së.

Anëtarët e Këshillit të Përgjithshëm dhe Myftinjtë, paraqiten problematikat që hasin dhe propozimet për projekte të reja.



Ambasadori i Austrisë në Tiranë viziton KMSH-në

Kryetari i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, H. Bujar Spahiu, priti në selinë e institucionit, Ambasadorin e Austrisë në Tiranë, Dr. Christian Steiner.

Bashkëbisedimi ndërmjet tyre u fokusua në marrëdhëniet e mira të deritanishme ndërmjet institucioneve dhe projekteve të përbashkëta që mund të organizohen në të ardhmen.

Në fjalën e tij, Ambasadori Steiner theksoi rëndësinë e harmonisë ndërfetare në shoqëri dhe vlerësoi kontributin e KMSH-së në këtë aspekt.

Ndërsa Kryetari i Komunitetit, z. Spahiu, pasi e falënderoi z. Steiner për vizitën u ndal në aktualitetin e institucionit dhe sfidave që mbart KMSH-ja për të qenë një institucion model në shoqëri.





Forumi Rinor Islam i Zvicrës viziton KMSH-në

Kryetari i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, H. Bujar Spahiu, priti në një vizitë në selinë e institucionit, një delegacion nga Forumi Rinor Islam i Zvicrës, të kryesuar nga nënkryetari i këtij forumi, z. Selami Hyseni.

Gjatë këtij takimi, Kryetari Spahiu, u uroi mirëseardhjen bashkatdhetarëve nga Zvicra dhe i njohu me punën dhe aktivitetin e Komunitetit Mysliman ndër vite.

Ndërsa z. Hyseni, falënderoi Kryetarin e KMSH-së për mikpritjen dhe u ndal në gatishmërinë e forumit që ai përfaqëson për të bashkëpunuar në fusha të ndryshme, kryesisht në fushën e kulturës, botimeve etj.

Bashkëbisedimi vijoi më tej me diskutime mbi tematika të ndryshme aktuale dhe çështje që prekin shqiptarët e diasporës.





Nënkryetari i KMSH-së mban hytbe në Xhaminë e Pazarit të Ri në Tiranë

Në kuadër të muajit Rabiul Euuel, muaji në të cilin ka lindur Profeti Muhamed a.s, nënkryetari i KMSH-së, z. Taulant Bica, ka mbajtur në xhaminë e Kokonozit (Pazarit të Ri) në Tiranë hytben e radhës mbi shembullin më të përkryer të njerëzimit, Profetin Muhamed a.s. Gjatë kësaj hytbeje nënkryetari u ndal te vlerat, virtytet, morali, mëshira, dhe shembulli i përkryer i Profetit Muhamed a.s.

“Profeti ynë nuk është i dërguar vetëm për një popull të caktuar, siç ishin të dërguarit para tij, por i dërguar për mbarë njerëzimin. Dhe kjo është një nga dallimet mes Profetit Muhamed a.s me Profetët e para-dërguar. Ndërkohë në Kur’anin Famëllartë për këtë thuhet: “Ne të kemi dërguar ty (o Muhamed) vetëm si sjellës të lajmit të mirë dhe paralajmërues për të gjithë njerëzimin, por shumica e njerëzve nuk dinë”. – tha ai gjatë kësaj hytbeje.



Kryetari i KMSH-së pret në takim Ambasadorin e Lirisë së Besimit në SHBA

Kryetari i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, H. Bujar Spahiu, priti në një takim Ambasadorin e Plotfuqishëm të Lirisë së Besimit në SHBA, z. Samuel Brownback.

Kryetari i KMSH-së, e njohu z. Brownback me historikun e KMSH-së, ecurinë e tij, sfidat, rrjetin arsimor si dhe me aktivitetin e tij. Ai gjithashtu e falënderoi ambasadorin për kontributin e SHBA-ve në promovimin e paqes, lirisë fetare dhe vlerave të tjera demokratike si dhe shprehu mirënjohjen për mbështetjen dhe bashkëpunimin e ngushtë me Komunitetin Mysliman në projekte të ndryshme. Ambasadori e falënderoi kreun e KMSH-së për kontributin dhe qëndrimet e tij si dhe sugjeroi që udhëheqësit fetarë nga Shqipëria të jenë shembull dhe iniciatorë të paqes dhe bashkëjetesës për vendet e tjera ku ka patur konflikte të natyrave të ndryshme.





Kreu i KMSH-së merr pjesë në konferencën “Feja si instrument i Paqes”

Kryetari i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, H. Bujar Spahiu, mori pjesë në Konferencën me temë: “Feja si Instrument i Paqes”, e cila u organizua nga Presidenti i Republikës së Shqipërisë, SH.T.Z. Ilir Meta, në bashkëpunim me Departamentin Amerikan të Shtetit.

Konferenca është hapur me fjalën përshëndetëse të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, z. Ilir Meta, për të vazhduar me përshëndetjet e Ambasadorit për Liritë Fetare në Departamentin e Shtetit, z. Samuel Brownback, si dhe me përshëndetjet e përfaqësuesve më të lartë të vendeve të rajonit.

Ndërsa në sesionin e dytë ishin të pranishëm përfaqësuesit e Komuniteteve fetare të vendit.

Kryetari i KMSH-së në fjalën e tij tha se fryma e besimit i mëson njeriut të jetë respektues me të tjerët, pranues i të ndryshmes dhe diversitetit, si dhe të jetë bashkëpunues me qëllimin e përbashkët për zhvillimin e vendit dhe shoqërisë, emancipimin, integrimin dhe edukimin e saj. Gjithashtu ai tha se në Kur’an spikasin mirëkuptimi, paqja, këshilla për të qenë të drejtë dhe dinjiteti njerëzor.

Në këtë konferencë ishin gjithashtu të ftuar studiues dhe përfaqësues të institucioneve dhe komuniteteve fetare nga rajoni dhe më gjera të cilët kanë referuar punimet e tyre në sesionet e tjera të konferencës.

RELIGION
AS AN INSTRUMENT
FOR PEACE









RELIGION
INSTRUMENT

PRESIDENT
IN COOPERATION

TIRANA, ALBANIA



REGION AS AN INSTRUMENT FOR PEACE

MINISTRY OF THE REPUBLIC OF ALBANIA
COORDINATION WITH U.S. DEPARTMENT OF STATE

18-19 NOVEMBER 2019



Frytet e besimit ndalen në Xhaminë “Dine Hoxha”, Tiranë

Cikli i mbrëmjeve fetare “Frytet e Besimit” u zhvillua në xhaminë “Dine Hoxha” në Tiranë, ku ishin të ftuar Nënkrjetari i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, z. Taulant Bica, Myftiu i Tiranës, z. Lauren Luli dhe Profesori Jornadez i Departamenti të Shkencave Islame të KU Bedër, z. Xhemal Seferti.

Në fjalën e tij hapëse, Imami i kësaj Xhamie, z. Ahmed Kalaja, pasi falënderoi të ftuarit dhe besimtarët e pranishëm për pjesëmarrjen, u ndal në rëndësinë e organizimeve të tilla në jetën e besimtarëve.

Më tej, fjalën e mori Myftiu i Tiranës, z. Luli, i cili e cilësoi këtë cikël takimesh si ndjekje të shembullit profetik. Sipas tij, tradita profetike na mëson ta përmendim dhe përhapim më tej fjalën e Zotit dhe ky cikël takimesh është dëshmi e qartë e angazhimit në zhvillimin e aktiviteteve fetare.

Nënkrjetari i KMSH-së, z. Taulant Bica, referoi mbi shembullin e jetës së Profetit. Sipas tij, rifreskimi i besimit është detyrë e gjithsecilit nga ne për të mbajtur lart vlerat e besimit dhe të praktikimit të Islamit. E për ta bërë këtë, nuk ka shembull më të përkryer sesa jeta e të dërguarit tonë fisnik.

Programi vazhdoi më tej me referimin e Profesorit nga Jordania, z. Xhemal Seferti. I cili ndau me besimtarët e pranishëm rëndësinë e qëndrueshmërisë apo stabilitetit në fe.

Programi vazhdoi më tej me diskutime të ndryshme.



Përfaqësues të KMSH-së vizitojnë familjet e prekura nga tërmeti në Thumanë

Kryetari i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, H. Bujar Spahiu, i shoqëruar nga përfaqësues të tjerë të lartë të institucionit si dhe Rektori i KU Bedër, Prof. Dr. Ferdinand Gjana, vizituan familjet e prekura nga tërmeti në Thumanë.

Gjatë kësaj vizite, ku u pritën nga znj. Eglantina Gjermeni, Ministre e Zhvillimit Urban, ata dorëzuan ndihmat e para materiale të mbledhura deri më tani në qendrën e emergjencave civile, qendër e cila do të bëjë më pas edhe shpërndarjen tek familjet në fjalë.

Gjatë bashkëbisedimit Ministrja, znj. Gjermeni u ndal në menaxhimin e situatës, mbi nevojat e familjeve, etj.

Ndërsa Kryetari i Komunitetit Mysliman, z. Spahiu, fillimisht shprehu ngushëllimet e tij për personat që nuk mundën ti mbijetojnë kësaj tragjedie. Më tej ai u ndal në angazhimin e Komunitetit Mysliman të Shqipërisë bashkë me të gjitha organet e tij në rrethe si xhami, medrese, Kolegjin Universitar “Bedër” dhe myftini, të cilat në mënyrë të organizuar po punojnë vazhdimisht në mbledhjen e ndihmave

Më tej ata u njohën nga afër me problematikat aktuale që kanë qindra familjet e strehuara përkohësisht në çadrat e emergjencave civile si dhe shprehën ngushëllimet për të afërmit e humbur një ditë më parë.



Kryetari i KMSH-së merr pjesë në ceremoninë mortore të familjes Lala

Kryetari i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, H. Bujar Spahiu, sëbashku me Myftiun e Tiranës, z. Lauren Luli, morën pjesë në ceremoninë mortore të familjes Lala në Durrës.

Fillimisht ata kryen homazhet në ambientet e Pallatit të Kulturës ku sëbashku me dhjetëra personalitete të tjera publike, i shprehën ngushëllimet e tyre familjarëve dhe të afërmeve të familjes Lala.

Më pas, të ndjerët u përcollën për në varrezat e qytetit, ku Kryetari i KMSH-së, z. Spahiu, priu në namazin e xhenazesë në të cilin morën pjesë dhjetëra besimtarë.

Në fjalën e tij para faljes së namazit, Kryetari Spahiu, ngushëlloi familjarët dhe bëri thirrje për solidaritet dhe mbështetje ndaj njëri tjetrit në këto ditë të vështira.

Në fund ai ju lut Allahut (xh.xh) të mëshirojë të ndarët nga jeta dhe të zbresë mbi kombin tonë qetësi dhe mëshirë.



d

aktivitete

hjetor

Besimtarët e Bujanovcit solidarizohen me familjet e prekura nga tërmeti

Kryetari i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, H. Bujar Spahiu, priti në një vizitë në selinë e institucionit një delegacion me përfaqësues të Këshillit të Bashkësisë Islame të Bujanovcit, të drejtuar nga Kryeimami, z. Ragmi Destani.

Gjatë kësaj vizite u bë dorëzimi i kontributit të besimtarëve të Bujanovcit për familjet e prekura nga tërmeti i 26 nëntorit në vendin tonë.

Në fjalën e tij, z. Destani, shprehu mbështetjen e institucionit që ai përfaqëson në kalimin e kësaj situatë të vështirë me të cilën po përballlet vendi ynë.

Ndërsa Kryetari Spahiu, pasi i falënderoi të pranishmit për mbështetjen institucionale, shprehu falënderimet e tij për të gjithë besimtarët e Bujanovcit të cilët u solidarizuan me familjet e prekura nga tërmeti.





Bashkësitë Islame të Preshevës dhe e Serbisë në Novi Pazar, solidarizohen me familjet e prekura nga tërmeti

Kryetari i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, H. Bujar Spahiu, priti në shtëpi të institucionit dy përfaqësues të Bashkësisë Islame të Preshevës dhe Bashkësisë Islame të Serbisë në Novi Pazar. Gjatë kësaj vizite, ata i dorëzuan Kryetarit të KMSH-së, z. Spahiu, kontributin monetar të mbledhur nga besimtarët përkatës të Bashkësive Islame për familjet e prekura nga tërmeti i 26 nëntorit në vendin tonë. Në fjalën e tyre, të dy përfaqësuesit e Bashkësive Islame të lartpërmendura shprehën mbështetjet institucionale në normalizimin e kësaj situatë dhe përcollën tek Kreu i KMSH-së, mesazhet solidarizuese të besimtarëve të vendeve përkatëse. Bashkëbisedimi vijoi më tej me tematika të ndryshme aktuale.





Zhvillohet konferenca: “Roli i Feve në Promovimin e Tolerancës: Nga mundësia në domosdoshmëri”

Kryetari i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, H. Bujar Spahiu i shoqëruar nga Kancelari i Institucionit, z. Ylli Cikalleshi dhe Këshilltari për Marrëdhëniet me Botën Arabe, z. Xhemal Saferti, morën pjesë në konferencën tre ditore të organizuar nga Forumi për Konsolidimin e Paqes në Shoqëritë Myslimane, me temë: “Roli i Feve në Promovimin e Tolerancës: Nga mundësia në domosdoshmëri”.

I ftuar me ftesë të posaçme nga kryetari i forumit, z. Abdullah bin Bejah, gjatë kësaj vizite, Kreu i KMSH-së, zhvilloi takime të ndryshme me personalitete dhe dijetarë që merrnin pjesë njëkohësisht në konference, të tillë si: Sekretari i Përgjithshëm i Ligës së Botës Islame, Dr. Muhamed bin Abdulkërim el-Isa, Ministri i Çështjeve Fetare të EBA-së, z. Muhamed Metar Salim el-Ka’bi, Ministri Egjiptian i Vakfeve, z. Muhamed Muhtar el-Xhuma, etj, duke i njohur ata me mbarëvajtjen e fesë islame në Shqipëri si dhe me institucionin e Komunitetit Mysliman të Shqipërisë dhe me veprimtaritë e tij.

Kjo konferencë, e cila u zhvillua nën kujdesin e Ministrit të Jashtëm dhe Bashkëpunimit Ndërkombëtar të EBA, z. Abdullah bin Zayed al-Nihjan, mbledhi sëbashku personalitete, udhëheqës fetarë dhe politik, dijetarë, studiues dhe akademikë të feve të ndryshme nga e gjithë bota për të diskutuar mbi rolin e besimeve fetare në promovimin e tolerancës dhe bashkëjetesës.



Inaugurohet xhamia e re e fshatit “Suç” të Myftinisë Mat

Të pranishëm në këtë ceremoni ishin Drejtori i Arsimit dhe Kulturës pranë Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, z. Dorian Demetja, Myftiu i Matit, z. Fabjon Kolaveri, Myftiu i Dibrës, z. Muis Kurtulla, Drejtori i Shoqatës “Komiteti i Bashkuar Kuvajtian për Bamirësi”, z. Ibrahim Mekki, dijetari dhe humanisti i njohur nga Kuvajti, z. Nebil el Auadi, si dhe donatorët, kontribuuesit dhe besimtarë të shumtë të fshatit Suç të rrethit Mat.

Në fjalën e tij përshëndetëse, Drejtori i Arsimit dhe Kulturës pranë KMSH-së, z. Demetja, shprehu falënderime ndaj të gjithë atyre që kontribuan dhe bënë të mundur ndërtimin e kësaj xhamie kaq të domosdoshme për besimtarët e zonës.

Ndërsa Myftiu i Matit, z. Kolaveri, në fjalën e tij u shpreh se rëndësia dhe roli i veçantë që do të luajë ndërtimi i kësaj xhamie qëndrojnë në kultivimin e vlerave më të larta njerëzore dhe krijimin e një atmosfere më të mirë shpirtërore për zonën.

Kjo xhami u ndërtua falë kontributit të shoqatës “Komiteti i Bashkuar Kuvajtian për Bamirësi”.

Pas prerjes së shiritit të përrurit, të pranishmit e shumë falën bashkarisht edhe namazin e parë në xhaminë e re të Fshatit Suç.



Vijon mbështetja për familjet e prekura nga tërmeti

Kryetari i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, H. Bujar Spahiu, priti në një vizitë në selinë e institucionit, koordinatorin e shtabit të emergjencave civile pranë organizatës “Liga e Botës Islame” me qendër në Arabinë Saudite, z. Omer Mahdi Hamdi Eadi.

Gjatë kësaj vizite u diskutua mbi situatën e krijuar nga tërmeti i 26 nëntorit dhe gjendjen aktuale të familjeve të prekura si pasojë e tij.

Në fjalën e tij, z. Wadi, shprehu mbështetjen e institucionit që ai përfaqëson në kalimin e kësaj situatë të vështirë.

Ndërsa Kryetari Spahiu, e njohu atë me punën që institucioni i KMSH-së, nëpërmjet të gjithë organizmave të tij në rrethe ka bërë në menaxhimin e situatës.

Më tej, ata diskutuan mbi mundësitë e bashkëpunimit në projekte të përbashkëta për t’ju ardhur në ndihmë familjeve të prekura nga tërmeti.





Delegacioni i Unioneve të Bashkësive Islame Shqiptare të Europës, viziton KMSH-në

Kryetari i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, H. Bujar Spahiu, priti në një vizitë në selinë e institucionit, Delegacionin e Unioneve të Bashkësive Islame Shqiptare në Zvicër, Gjermani, Austri dhe Itali.

Ky delegacion gjendet prej disa ditësh në Shqipëri, ku sëbashku me përfaqësues të KMSH-së kanë vizituar nga afër zonat e prekura nga tërmeti i 26 nëntorit dhe në koordinim me këta të fundit do të vlerësojnë dhënien e kontributeve të konsiderueshme të mbledhura nga thirrjet në xhamitë e respektive.

Në fjalën e tij, Kryetari i KMSH-së, z. Spahiu, pasi shprehu falënderimet e tij për vizitën, solidarizimin dhe mbështetjen institucionale të këtyre bashkësive Islame, u ndal në frymën e bashkëpunimit që duhet të karakterizojë shqiptarët brenda dhe jashtë kufijve të vendit në kalimin e situatave të tilla.

Ndërsa përfaqësuesit e unioneve të pranishëm në këtë takim, shprehën jo vetëm gatishmërinë e institucioneve që përfaqësojnë por edhe mesazhet solidarizuese të shqiptarëve që jetojnë në vendet respektive të këtyre bashkësive Islame.

Në fund të takimit, Kryetari i KMSH-së, u dorëzoi të pranishmëve disa certifikata mirënjohjeje dhe vlerësimi për kontributet e ndryshme të dhëna deri më tani nga këta bashkësi Islame.



Kryetari i KMSH-së pret në një takim pune myftinjtë e vendit

Kryetari i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, H. Bujar Spahiu, zhvilloi në selinë e institucionit një takim pune me të gjithë myftinjtë e rretheve të vendit.

Ky takim vjen si nevojë e diskutimit të mënyrës së menaxhimit të ndihmave që çdo myftini ka mbledhur me anë të thirrjeve në xhamitë përkatëse dhe fondeve të ardhura nga burime të tjera për familjet e prekura nga tërmeti i 26 nëntorit.

Në fjalën e tij, kryetari Spahiu falënderoi të gjithë myftinjtë për angazhimin, kontributin dhe mbledhjen e fondeve monetare dhe materiale për familjet e lartë përmendura.

Takimi vijoi më tej me nënkryetarin e KMSH-së, z. Taulant Bica, kancelarin, z. Ylli Cikalleshi dhe drejtorin e Vakf-Investimeve, z. Edison Hoti, të cilët ndanë me të pranishmit një tablo përshkruese të gjithë angazhimit të institucionit të KMSH-së, dhe fushatës së ndihmave të ndërmarrë në shërbim të kësaj ngjarjeje.

Takimi vijoi më tej me sugjerime dhe diskutime të ndryshme nga të pranishmit mbi menaxhimin e vlerave monetare, koordinimit të punës dhe prioritetet e radhës në tejkalimin e kësaj situate.





Presidenti Meta takon krerët e Komuniteteve Fetare

Kryetari i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, H. Bujar Spahiu, mori pjesë në takimin e organizuar nga Presidenti i Republikës, Sh.T.Z. Ilir Meta, me krerët e Komuniteteve Fetare në Shqipëri, ku u diskutua mbi situatën e pas tërmetit të 26 nëntorit dhe pasojat jo vetëm materiale, por dhe shpirtërore të qytetarëve në zonat e prekura nga kjo fatkeqësi natyrore.

Kryetari Spahiu, gjatë takimit tha se Komuniteti Mysliman i Shqipërisë është sensibilizuar menjëherë pas tërmetit në koordinim me Myftinitë, Universitetin “Bedër”, Medresetë dhe organet e tjera shtetërore për t’ju ardhur në ndihmë familjeve të prekura nga tërmeti.

Presidenti Meta, i falënderoi krerët e bashkësive fetare për reagimin e tyre të menjëhershëm, duke u gjendur pranë njerëzve në këto momente të vështira dhe vlerësoi mbështetjen e tyre të pazëvendësueshme materiale, shpirtërore, morale dhe psikologjike.

Kryetari i KMSH-së, z. Spahiu, e falënderoi Presidentin Meta për ftesën dhe vlerësoi angazhimin e tij në stimulimin e bashkëpunimit të institucioneve të ndryshme në përmirësimin e kësaj situatë dhe rolin e tij unifikues.



Hap dyert xhamia e re e fshatit “Pezë e Vogël”, Tiranë

Nën një atmosferë të ngrohtë shpirtërore, me lexim Kur’ani, ilahi dhe përshëndetje të ndryshme nga të ftuarit e nderit, u hapën sot dyert e xhamisë së “Hadmit” në fshatin Pezë e Vogël, Tiranë. Në ceremoninë e inaugurimit ishin të pranishëm Kryetari i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, h. Bujar Spahiu, Myftiu i Tiranës, z. Lauren Luli, përgjegjësi i çështjeve fetare pranë Ambasadës së Arabisë Saudite në Tiranë, z. Hamd el-Saj’arij, si dhe dhjetëra besimtarë të këtij fshati. Në fjalën e tij përshëndetëse, Kryetari i KMSH-së, z. Spahiu, pasi falënderoi donatorët për kontributin në restaurimin e kësaj xhamie, u ndal në rëndësinë që duhet ti kushtojnë besimtarët e zonës frekuencimit të saj.

Më tej, Myftiu i Tiranës, z. Luli, shprehu mirënjohjen e tij ndaj të gjithë atyre që bënë të mundur restaurimin e kësaj xhamie dhe theksoi rihapjen e saj si një domosdoshmëri për formimin e qytetarëve dhe individëve me vlera të larta morale e shoqërore.

Pas prerjes së shiritit të përrurimit, besimtarët e pranishëm falën sëbashku namazin e xhumasë, hytben e së cilit e mbajti Kryetari i KMSH-së, z. Spahiu, mbi temën: “Pozita e njeriut sipas Islamit”.

Restaurimi i kësaj xhamie u bë falë kontributit të Ministrisë së Çështjeve Fetare të Arabisë Saudite në bashkëpunim me Ambasadën e Arabisë Saudite në Tiranë, ndërsa projekti i restaurimit të saj u implementua nga Komuniteti Mysliman i Shqipërisë.



Përmbajtja

Roli i gruas në shoqërinë moderne sipas këndvështrimit Islam	8
Drejtori i Përgjithshëm i Deutsche Welle viziton KMSH-në	12
Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit Botëror të Komuniteteve Myslimane, viziton KMSH-në	14
Abu Dabi: Nënshkruhet “Dokumenti i vëllazërisë njerëzore”	18
Abu Dabi: “Zhvillon punimet Konferenca Globale e Vëllazërisë njerëzore”	20
Zhvillohet konferenca “Feja dhe përshtirëria në marrëdhëniet mes të krishterëve dhe myslimanëve”	22
H. Bujar Spahiu zgjidhet Kryetar i Ri i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë	26
H. Skender Bruçaj uron kryetarin e ri të KMSH-së	30
Kreu i Kryegjyshitës Botërorë Bektashiane uron Kryetarin e KMSH-së	32
Kreu i KMSH-së pret në një takim kryetaren e Komitetit Shtetëror për Kultet	34
Nunci Apostolik në Shqipëri viziton Kryetarin e KMSH-së	36
Kryetari i Konferencës Ipeshkvore të Shqipërisë uron kreun e KMSH-së	38
Medreseja e Tiranës uron kreun e KMSH-së për detyrën e re	40
Kryetari i KMSH-së takim me myftiun dhe imamët e Fierit	42
Kryetari i KMSH-së pret në takim ambasadorin e Austrisë	44
Kreu i KMSH-së pret në takim kryetarin e BFI të RMV, H. Sulejman ef. Rexhepin	46
Kryetari i KMSH-së pret në një takim Myftiun dhe imamët e Shkodrës	50
Kreu i KMSH-së pret në një takim drejtues të AIITC-së	52
Myftinia e Elbasanit uron kreun e KMSH-së	54
Kryetari i KMSH-së takim me myftinitë e Korçës, Pogradecit dhe Devollit	56
Myftinia e Kukësit viziton kreun e KMSH-së	58
Kryetari i KMSH-së pret në një takim ambasadorin e Kuvajtit	60
Kreu i KMSH-së takim me myftiun dhe imamët e Beratit	62
Drejtori i Qatar Charity viziton Kreun e KMSH-së	64
KMSH-Bedër, promovojnë librin “Argumentet bazë të Fikhut Hanefi”	66
Bashkësia Islame për Preshevën, Bujanovcin dhe Medvegjën vizitojnë KMSH-në	68
Kreu i KMSH-së takim me Koordinatorin Kombëtar për Parandalimin e Ekstremizmit të Dhunshëm	70
Kryetari i KMSH-së takim me myftiun dhe imamët e Krujës	72
Kryetari Spahiu pret në një takim Ambasadorin e Hungarisë	74
Kryetari i KMSH-së pret në një takim myftiun dhe imamët e Sarandës	76
Kryetari i KMSH-së takim me myftiun dhe imamët e Vlorës	78
Myftinia e Peqinit viziton Kreun e KMSH-së	80
Kreu i KMSH-së pret në takim drejtorin e Fondacionit “Mirënjohja për Evropën dhe Ballkanin”	82
Myftinia e Dibrës, Bulqizës dhe ajo e Matit urojnë kreun e KMSH-së	84
Myftinia Pukë viziton kryetarin e KMSH-së	86
Ambasadorja e Gjermanisë në Tiranë viziton KMSH-në	88
Myftinia e Gjirokastrës viziton kryetarin e KMSH-së	90
Myftinia e Lushnjës viziton kryetarin e KMSH-së	92
Myftiu i Gramshit dhe ai i Përmetit vizitojnë kryetarin e KMSH-së	94
Departamenti i Shkencave Islame në Bedër viziton Kreun e KMSH-së	96
Rektori i KU “Bedër” viziton kryetarin e KMSH-së	98
Kryetari i Tarikatit “Rifai” viziton kreun e KMSH-së	100
Myftinia e Librazhdit viziton kreun e KMSH-së	102
Kryetari i KMSH-së pritë në një takim myftiun e Tropojës	104
Ambasadori i Egjiptit në Tiranë viziton kryetarin e KMSH-së	108
Kryetari i Tarikatit “Kadiri” viziton kreun e KMSH-së	110

Myftiu i Kavajës uron kryetarin e KMSH-së	112
Myftiu, Naim ef. Tërnavë sëbashku me përfaqësues të tjerë të BIK vizitojnë KMSH-në	114
Nisin “Frytet e Besimit” në qytetin e Kavajës	118
Drejtori i Përgjithshëm i Burgjeve viziton KMSH-në	120
I ngarkuari me punë i Ambasadës së Kosovës viziton KMSH-në	122
Këshilli i Presidencës së Këshillit Ndërfetar të Shqipërisë zhvilloi mbledhjen e radhës dhe të parën për vitin 2019 ...	124
Cikli i mbërmejeve fetare “Frytet e Besimit” u zhvillua në Xhaminë e Medresesë, Tiranë	128
Kryetari i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, H. Bujar Spahiu, vizitoi Presidentin e Republikës, Sh.T.Z. Ilir Meta	130
Kryepeshkopi i Kishës Ortodokse Autoqefale të Shqipërisë, viziton KMSH-në	132
KMSH nis fushatën në ndihmë të 7300 familjeve në nevojë	136
“Frytet e Besimit” ndalen në Xhaminë e “Pazarit” në Krujë	140
Myftinia e Elbasanit organizon programin festiv “Ramazani, muaji i vlerave dhe i harmonisë”	142
Kryetari i KMSH-së merr pjesë në konferencën ndërkombëtare në Arabinë Saudite	146
“Feja në shoqëri: Modeli Shqiptar”	148
Ramazani 2019, KMSH shtron iftarin e parë	152
Dobitë shpirtërore dhe ato fizike të muajit të Ramazanit	158
Zhvillohet konferenca me temë: “Të mbrojmë familjen si tempull të shenjtë”	160
Bashkia Tiranë shtron iftar për Komunitetin Mysliman të Shqipërisë	162
Ramazani mes nesh	166
Nënshkruhet memorandum mirëkuptimi mes Këshillit Ndërfetar dhe CVE- së	170
Kryetari i KMSH-së viziton Myftininë e Korçës	172
Myftinia e Shkodrës shtron iftar me personalitete dhe intelektualë të qytetit	176
Studentët nga 8 universitete vizitojnë KMSH-në	178
Kryetari i Kuvendit, z. Gramoz Ruçi, shtron iftar për Muajin e Ramazanit	180
Ambasada e SHBA-ve shtron iftar me rastin e Ramazanit	184
Zyra e Gruas, iftar me personalitete të vendit	188
Presidenti Meta shtron iftar me rastin e muajit të Ramazanit	192
Myftinia e Lushnjës shtron iftar për besimtarët e qytetit	196
Myftinia Vlorë shtron iftar për besimtarët e qytetit	198
Kryeministri Rama shtron iftar në Natën e Kadrit	200
Besimtarët myslimanë festojnë Fitër Bajramin	202
Besimtarët myslimanë festojnë Fitër Bajramin	210
Zhvillohet konferenca Rajonale me temë: “Roli i Fesë në Ballkanin Perëndimor”	216
“Kryet Nalt”, shfaqet dokumentari për klerikun Hafiz Ali Kraja	220
Kryetari i KMSH-së pret në një takim Ambasadorin e Zvicrës	222
Inaugurohet fillimi i punimeve të Xhamisë së re në Kiras, Shkodër	224
Kryetari i KMSH-së viziton Medresenë e Korçës	226
Kolegji Universitar Bedër diplomon brezin e 6-të të studentëve	228
Kryetari i KMSH-së pret në një takim zv/ministrin kuvajtian të vakëfeve	234
Prezantohet Myftiu i ri i Tiranës	238
Imami i Komunitetit Shqiptaro-Amerikan viziton kryetarin e KMSH-së	240
Kreu i KMSH-së pret në takim përfaqësuesin e Shtëpisë së Zekatit në Kuvajt	242
Kreu i KMSH-së merr pjesë në ministerialin e organizuar nga DASH	244
Drejtori i Projekteve Ndërkombëtare të Qatar Charity viziton KMSH-në	248
Haxhinjtë shqiptarë nisen drejt Mekës e Medines	252
Kryetari i KMSH-së pret në një takim zyrtaren e DASH	254
Nënkryetari i KMSH-së mban hytbe në xhaminë e “Selitës” në Tiranë	256

Besimtarët myslimanë festojnë Kurban Bajramin	258
Personalitete të vendit urojnë besimtarët për Kurban Bajram	264
KMSH shpërndan mijëra kurbane në të gjithë vendin	268
Përfaqësuesi i Ministrisë për Çështjet Islame të Arabisë Saudite viziton KMSH-në	272
Kryetari i KMSH-së mban hytben në xhaminë e qendrës, Kavajë	274
Ambasadorja e Palestinës në Tiranë viziton KMSH-në	276
Dr. Rexhep Boja, ish-kryetar i BIK viziton KMSH-në	278
Nënkryetari i KMSH-së uron vitin e ri shkollor nga Medreseja e Tiranës	280
KMSH i vjen në ndihmë familjes Lita	282
Kreu i KMSH-së takon ministrin e çështjeve fetare dhe vakëfeve në Egjipt	284
Kryetari i KMSH-së mban hytben në xhaminë e qendrës, Kamëz	286
Kreu i KMSH-së takim me zv/presidentin e Federatës Universale të Paqes	288
Myftiu i Tiranës merr pjesë në 40-vjetorin e Xhamisë Boshnjako-Shqiptare në Frankfurt	290
Zhvillohet konferenca mediatike: “Radiot fetare në gjuhën shqipe”	294
Kreu i KMSH-së mban hytbe në xhaminë “Mbret” në Elbasan	298
Komisioneri për Mbrojtjen nga diskriminimi viziton KMSH-në	302
Nënkryetari i KMSH-së mban hytbe në xhaminë e qendrës në Librazhd	304
KU “Bedër” hap dyert për vitin e ri akademik 2019-2020	306
Rikthehet cikli i mbrëmjeve fetare “Frytet e besimit”	312
Inaugurohet xhamia e re “Arrameras” në Fushë-Krujë	314
Kryetari i KMSH-së mer pjesë në Samitin e Paqes për Evropën Juglindore	318
“Frytet e Besimit” zhvillohen në xhaminë e Sahatit, Berat	322
Nënkryetari i KMSH-së pret në një takim drejtorin e KMBFGR-së në Maqedoninë e Veriut	324
Kreu i KMSH-së zhvillon vizitë zyrtare në Arabinë Saudite	326
Kreu i KMSH-së takim me presidentin e Bankës Islamike për Zhvillim	332
Kreu i KMSH-së takim me sekretarin e përgjithshëm të qendrës “Mbreti Selman”	334
Kryetari i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë zhvillon takime me zyrtarë të lartë në Mbretërinë e Arabisë Saudite	336
Vijojnë vizitat dhe takimet në Mbretërinë e Arabisë Saudite	340
Angazhimi i të rinjve për ndërtimin e një komuniteti të qëndrueshëm	344
Mblidhet Këshilli i Përgjithshëm i KMSH-së	348
Ambasadori i Austrisë në Tiranë viziton KMSH-në	350
Forumi Rinor Islam i Zvicrës viziton KMSH-në	352
Nënkryetari i KMSH-së mban hytbe në Xhaminë e Pazarit të Ri në Tiranë	354
Kryetari i KMSH-së pret në takim Ambasadorin e Lirisë së Besimit në SHBA	356
Kreu i KMSH-së merr pjesë në konferencën “Feja si instrument i Paqes”	358
Frytet e besimit ndalen në Xhaminë “Dine Hoxha”, Tiranë	364
Përfaqësues të KMSH-së vizitojnë familjet e prekura nga tërmeti në Thumanë	366
Kryetari i KMSH-së merr pjesë në ceremoninë mortore të familjes Lala	368
Besimtarët e Bujanovcit solidarizohen me familjet e prekura nga tërmeti	372
Bashkësitë Islame të Preshevës dhe e Serbisë në Novi Pazar, solidarizohen me familjet e prekura nga tërmeti	374
Zhvillohet konferenca: “Roli i Feve në Promovimin e Tolerancës: Nga mundësia në domosdoshmëri”	376
Inaugurohet xhamia e re e fshatit “Suç” të Myftinisë Mat	378
Vijon mbështetja për familjet e prekura nga tërmeti	380
Delegacioni i Unioneve të Bashkësive Islame Shqiptare të Europës, viziton KMSH-në	382
Kryetari i KMSH-së pret në një takim pune myftinj të vendit	384
Presidenti Meta takon krerët e Komuniteteve Fetare	386
Hap dyert xhamia e re e fshatit “Pezë e Vogël”, Tiranë	388

CIP Katalogimi në botim BK Tiranë

Komuniteti Mysliman i Shqipërisë

Aktivitete 2019

red. Agron Hoxha, Erzen Carja, KMSH.

Tiranë : Komuniteti Mysliman i Shqipërisë, 2020

394 f. : me foto ; 20x20cm.

ISBN 978-9928-194-83-1

1.Feja islame

2.Institucione fetare

3.Raporte

4.Shqipëri

28 –736(496.5) “2019”



www.kmsh.a1

